



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

**ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE**

Dokumenti nr: 21.6;22x.9-2016/17-08

RAPORTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS

**MEKANIZMAT INSTITUCIONAL PËR RREGULLIMIN LIGJOR,
MONITORIMIN DHE RAPORTIMIN E CILËSISË SË AJRIT**

Prishtinë, maj 2018

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, që me Kushtetutë dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative.

Zyra Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për ti kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve të tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditimet e performancës të ndërmarra nga Zyra Kombëtare e Auditimit janë shqyrtime të pavarura, objektive dhe të besueshme që vlerësojnë nëse veprimet qeveritare, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet ose organizatat veprojnë në përputhje me parimet e ekonomisë¹, efikasitetit² dhe efektivitetit³ dhe nëse ka vend për përmirësim.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me këtë raport “Mekanizmat Institucional për rregullimin ligjor, monitorimin dhe raportimin e cilësisë së ajrit” në konsultim me Ndihmës Auditoren e Përgjithshme Vlora Spanca, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Ekipi që e ka realizuar këtë raport:

Myrvete Gashi, Drejtor i Auditimit

Drilon Shala, Udhëheqës i ekipit

Labinot Sadiku, Anëtar i ekipit

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT – Adresa: Musine Kokalari, Nr. 87, Prishtinë 10000, Kosovë

Tel: +381(0) 38 60 60/1011

<http://zka-rks.org>

¹ Ekonomia – Parimi i ekonomisë nënkupton minimizimin e kostos së resurseve. Resurset e përdorura duhet të jenë në dispozicion me kohë, në sasi dhe cilësi të duhur dhe me çmimin më të mirë

² Efikasiteti – Parimi i efikasitetit nënkupton të marrësh maksimumin nga resurset në dispozicion. ka të bëjë me lidhshmërinë ndërmjet resurseve të angazhuara dhe rezultateve të dhëna në kuptim të sasisë, cilësisë dhe kohës.

³ Efektiviteti – Parimi i efektivitetit nënkupton arrijten e objektivave të paracaktuara dhe arrijten e rezultateve të pritura

TABELA E PËRMBAJTJES

Lista e shkurtesave	4
Përmbledhje e përgjithshme	5
1 Hyrje.....	7
1.1 Problemi i auditimit.....	8
1.2 Objektivi i auditimit	9
1.3 Pyetjet e auditimit.....	9
1.4 Kriteret e auditimit	10
1.5 Fushëveprimi i auditimit	12
1.6 Metodologjia e auditimit	13
2 Përgjegjësitë e institucioneve kryesore dhe dokumentet relevante.....	14
2.1 Dokumentet relevante.....	15
3 Të gjeturat	16
3.1 Statusi i përcaktimit, azhurnimit dhe fuqizimit të parakushteve ligjore për rregullimin e cilësisë së ajrit	16
3.2 Monitorimi dhe raportimi i cilësisë së ajrit	18
3.3 Roli dhe menaxhimi i cilësisë së ajrit në nivel lokal.....	35
4 Konkluzionet	39
5 Rekomandimet	42
Shtojca 1.....	44

Lista e shkurtesave

AMMK	Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
DMMU	Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit dhe Ujerave
IHMK	Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OE	Operatorë ekonomik
PLVM	Planet Lokale të Veprimit në Mjedis
PVCA	Plani i Veprimit për Cilësi të Ajrit
UA	Udhëzim Administrativ

Përmbledhje e përgjithshme

Ndotja e ajrit ka ndikime të konsiderueshme shëndetësore, ekonomike dhe mjedisore. Ndikimi negativ i ajrit të ndotur është veçanërisht evident në shëndetin e qytetarëve, në veçanti të atyre që jetojnë në zona urbane dhe afër zonave industriale. Burime të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare kanë theksuar se kohëve të fundit ndotja e ajrit në Kosovë e shkaktuar nga burimet e dobëta të energjisë u rrit në nivele të rrezikshme për shëndetin.

Për të përmirësuar cilësinë e ajrit dhe parandaluar ndotjen, shtetet duhet të sigurojnë se kanë mekanizma ligjor, monitorues dhe raportues për adresimin e qasjes që duhet ndjekur për të përcjellë zbatimin e standardeve të cilësisë së ajrit dhe për të kontrolluar reduktimin e emisioneve. Në Kosovë, përgjegjësinë kryesore në kuadër të sistemit institucional të cilësisë së ajrit e bartë Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Kjo Ministri është përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikave dhe dokumenteve strategjike të cilësisë së ajrit, koordinimin e aktiviteteve për promovimin e politikave të mjedisit, vendosjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të normave dhe standardeve për mbrojtjen e mjedisit, etj. Përderisa, Komunitet janë përgjegjëse për miratimin e Planeve Lokale të Veprimit në Mjedis dhe programeve për mbrojtjen e mjedisit, si dhe për raportimin e zbatimit të këtyre planeve dhe programeve.

Për shkak të rëndësisë dhe ndikimit që cilësia e ajrit ka për mjedisin në tërësi ashtu edhe për faktorin njeri, Zyra Kombëtare e Auditimit është motivuar të kryejë auditimin e performancës “Mekanizmat Institucional për rregullimin ligjor, monitorimin dhe raportimin e cilësisë së ajrit”.

Objektiva e këtij auditimi është vlerësimi aktiviteteve të subjekteve përgjegjëse të nivelit qendror në vendosjen e kornizës ligjore dhe mekanizmave të monitorimit dhe raportimit të cilësisë së ajrit, si dhe vlerësimi i aktiviteteve të nivelit lokal në miratimin e planeve lokale të veprimit për cilësi të ajrit si dhe përfshirjen e tyre në menaxhimin e gjendjes së cilësisë së ajrit në nivel lokal.

Subjekt i këtij auditimi është Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit në kuadër të kësaj ministrie, Instituti Hidrometeorologjik në kuadër të kësaj Agjencie, si dhe në kuadër të nivelit lokal komuna e Prishtinës, Mitrovicës, Obiliqit, Hanit të Elezit dhe Gjilanit.

Ky auditim ka mbuluar aktivitetet e zhvilluara të nivelit qendror dhe lokal në menaxhimin e gjendjes së cilësisë së ajrit për vitet 2016 dhe 2017.

Konkluzionet kryesore

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor nuk i ka vendosur të gjitha parakushtet e nevojshme ligjore për rregullimin e gjendjes së cilësisë së ajrit në Kosovë si dhe nuk e ka azhurnuar të gjithë kornizën e nevojshme ligjore sipas gjendjes aktuale të cilësisë së ajrit në vend. Një kornizë e tillë nuk shërben si udhërrëfyes që lehtëson punën e institucioneve për të ndërmarrë masa konkrete në drejtim të përmirësimit të cilësisë së ajrit.

Sistemi aktual i monitorimit dhe raportimit të të dhënave për cilësi të ajrit ka rezultuar të jetë i mangët pasi që karakterizohet me parregullsi të shumta. Vetëm 17% e stacioneve monitoruese kanë qenë funksionale gjatë pjesës më të madhe të vitit 2017 ndërkohë që 33% e stacioneve kanë qenë

jashtë funksionit për më shumë se 7 muaj gjatë vitit. Për më shumë, këto stacione ishin dislokuar disa herë, raportimi i të dhënave ishte jo i rregullt dhe jo i plotë, mungon siguria dhe mbikëqyrje e vazhdueshme e stacioneve monitoruese, si dhe mungon sistemi qendror për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave që gjenerohen nga stacionet monitoruese.

Edhe pse kishte përmirësime në raportimin e parametrave nga viti 2016 në 2017, parametrat e rrezikshëm për shëndetin e njeriut që janë evident në vendin tonë, PM₁₀ dhe PM_{2.5} (grimcat e pluhurit) nuk janë raportuar mesatarisht 4.2 muaj gjatë vitit 2017, që nuk është pak veçanërisht nëse janë muaj të dimrit (muaj kur këta parametra arrijnë vlera maksimale). Pavarësisht raportimit të mangët, në ato raste kur është raportuar, janë regjistruar tejkalime alarmante të parametrat PM₁₀ që kanë arritur deri në 400% tejkalim. Mangësitë e identifikuara në sistemin e monitorimit dhe raportimit të të dhënave e bëjnë shumë të vështirë për vendimmarrësit identifikimin e masave konkrete për tu ndërmarrë për të përmirësuar gjendjen e cilësisë së ajrit.

Po ashtu, ngecje janë evidentuar edhe në nivel lokal që kanë të bëjnë me mos miratimin e planeve lokale për mjedis, mos raportimin e implementimit të këtyre planeve si dhe mos përtëritjen e planeve në momentin kur ato nuk janë të vlefshme.

Rekomandimet kryesore

Subjektet përgjegjëse të nivelit qendror dhe atij lokal, duhet të sigurohen se kanë vendosur një kornizë të plotë dhe të azhurnuar ligjore, si dhe mekanizma efikas e të qëndrueshëm të monitorimit dhe raportimit të cilësisë së ajrit në Kosovë.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor si institucion kyç në krijimin e kornizës së nevojshme ligjore për përmirësimin e cilësisë së ajrit duhet të kompletojë, azhurnojë dhe funksionalizojë sa më parë dokumentet kyçe që bëjnë rregullimin e cilësisë së ajrit në Kosovë siç janë Ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja, Strategjia për cilësi të ajrit si dhe Plani i Veprimit për Cilësi të Ajrit.

Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit, në mbështetje të Institutit Hidrometeorologjik, duhet që sa më parë të funksionalizojë në tërësi rrjetin monitorues të cilësisë së ajrit përmes dislokimit adekuat, servisimit dhe mirëmbajtjes së vazhdueshme të stacioneve monitoruese, krijimit të një sistemi të centralizuar të mbledhjes dhe përpunimit automatik të të dhënave, si dhe matjes dhe raportimit në kohë reale të gjendjes së cilësisë së ajrit.

Komunat duhet të sigurohen që sa më parë të miratojnë apo përtërijnë vlefshmërinë e planeve të tyre të veprimit për mjedis, si dhe të raportojnë në mënyrë të vazhdueshme dhe me informata të plota për zbatimin e masave që kanë të bëjnë me përmirësimin e cilësisë së ajrit e që janë të parapara në ato plane.

Përgjigja e palëve të përfshira në auditim

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Komunat e përfshira në auditim janë pajtuar me të gjeturat dhe rekomandimet e auditimit. Inkurajojmë institucionet e përfshira në këtë auditim që t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për t'i adresuar rekomandimet e dhëna.

1 Hyrje

Ndotja e ajrit është një çështje shumë e rëndësishme mjedisore dhe sociale, dhe njëkohësisht, është një problem kompleks që paraqet sfida të shumta në drejtim të menaxhimit dhe reduktimit të ndotësve të dëmshëm. Ajri i ndotur ka ndikim të konsiderueshëm në shëndetin e qytetarëve, veçanërisht atyre që jetojnë në zonat urbane. Po ashtu, ajri i ndotur ka ndikime të konsiderueshme ekonomike, duke shkurtuar jetëgjatësinë e qytetarëve, duke rritur kostot mjekësore si dhe duke reduktuar produktivitetin gjatë ditëve të punës së humbur në të gjithë ekonominë⁴.

Legjislacioni i ndotjes së ajrit ndihmon në adresimin e qasjes që duhet ndjekur për të përcjellë zbatimin e standardeve të cilësisë së ajrit dhe për të kontrolluar reduktimin e emisioneve. Po ashtu, të dhënat e monitorimit të cilësisë së ajrit të cilat raportohen në baza të rregullta sigurojnë bazën për vlerësimin e ekspozimit të popullsisë së një vendi ndaj tejkalimeve të standardeve të cilësisë së ajrit të përcaktuara si nga shtetet Evropiane ashtu edhe nga udhëzuesit e Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH).⁵

Pavarësisht progresit në vitet e fundit, disa standarde të cilësisë së ajrit ende tejkalohe gjerësisht në zonat më të dendura të Bashkimit Evropian, veçanërisht nga ndotësit si grimcat e imta (PM₁₀ dhe PM_{2.5}⁶), ozoni dhe dioksidi i azotit. Në Kosovë, situata nuk është më ndryshe pasi që me rritjen e zhvillimit ekonomik janë rritur edhe nivelet e ndotjes së ajrit, sidomos nga dy termocentralet e vjetra dhe rritja e qarkullimit të trafikut. Sipas Reuters⁷, gjatë stinës së dimrit, ndotja e ajrit në Prishtinë e shkaktuar nga burimet e dobëta të energjisë u rrit në nivele të rrezikshme për shëndetin. Në një deklaratë të lëshuar nga përfaqësues të OBSH⁸, e gjithashtu të dhëna të mbështetura edhe nga raportet e Bankës Botërore⁹ konstatohet se ndotja e ajrit në Kosovë u vlerësua të shkaktojë mbi 800 vdekje të parakohshme në vit.

Ndotja e ajrit në Kosovë është më e theksuar në zonat e zhvilluara urbane, posaçërisht në zonat industriale, ndërkohë që ndikimi më i madh në mjedis shkaktohet nga termocentralet e KEK-ut si dhe nga industritë (metalurgjia, mihjet, fabrikat e çimentos, etj.). Ndotje shkaktohet po ashtu nga objektet individuale për ngrohje.¹⁰ Përderisa çështja e cilësisë së ajrit është kaq e rëndësishme si për shëndetin e njeriut e njëkohësisht edhe për ambientin në tërësi, është më se e domosdoshme që të merren masat e nevojshme për të adresuar këtë çështje.

⁴ Agjencia Evropiane e Mjedisit, Nr. 28/2016, Cilësia e Ajrit në Evropë - 2016 raport, ISSN 1977-8449

⁵ Agjencia Evropiane e Mjedisit, SOER 2015, Përmbledhje shteti - Ambienti Evropian - shteti dhe perspektiva 2015, <https://www.eea.europa.eu/soer-2015/countries/kosovo>

⁶ Grimca 50% e të cilave kalojnë nëpër seleksionues me diametër aerodinamik prej 10, respektivisht 2.5 mikrometra.

⁷ Reuters (13 Shkurt 2017), Cilësia e Ajrit në Prishtinë jo i shëndetshëm, kafshimet e ftohta të dimrit, <https://www.reuters.com/article/us-balkans-pollution-kosovo/air-quality-in-pristina-unhealthy-cold-winter-bites-idUSKBN15S1MC>

⁸ Europa e Lire (20 Mars 2016) Organizata Botërore e Shëndetësisë: Nga ndotja e ajrit, mbi 800 vdekje në vit, <https://www.evropaelire.org/a/27624395.html>

⁹ Banka Botërore (Janar 2013), Kosovë - Analiza mjedisore e shtetit - Vlerësimi i kostos së degradimit mjedisor, rishikimi institucional dhe rishikimi i shpenzimeve publike për mjedisin

¹⁰ Strategjia e Cilësisë së Ajrit (2013), Strategjia e Cilësisë së Ajrit 2013-2022, Departamenti i Mjedisit, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

1.1 Problemi i auditimit

Ekzistojnë burime të ndryshme si vendore ashtu edhe ndërkombëtare të cilat kanë identifikuar një sërë problemesh që aktualisht ekzistojnë në Kosovë lidhur me gjendjen jo të mirë të cilësisë së ajrit. Këta indikatorë të problemit kanë motivuar edhe kryerjen e këtij auditimi. Ndër indikatorët e problemit që përmenden më së shpeshti janë mungesa e kompletimit të kornizës ligjore për cilësinë e ajrit si dhe mangësitë në monitorimin dhe raportimin e gjendjes së cilësisë së ajrit në vend.

Sipas burimeve të ndryshme indikatorët kryesor të problemit përfshijnë:

- Mos kompletimi i kornizës ligjore¹¹;
- Pjesa e kornizës legislative që tashmë është miratuar ka ende nevojë për tu përshtatur dhe transpozuar sipas kërkesave të Bashkimi Evropian¹²;
- Raportet e progresit të Komisionit Evropian për Kosovën kanë identifikuar që korniza ligjore duhet kompletuar si dhe ajo kornizë ligjore që tashmë është miratuar duhet të fuqizohet dhe gjejë zbatim në praktikë¹³;
- Sistemi i monitorimit të cilësisë së ajrit nuk është plotësisht funksional si rezultat i mungesës së matjeve në kohë reale dhe raportimit konsistent të gjendjes së cilësisë së ajrit¹⁴;
- Ka indikacione që ka ende komuna (sidomos aty ku niveli i ndotjes është i lartë) që nuk kanë miratuar planet lokale të veprimit për cilësinë e ajrit apo edhe të tilla që nuk i kanë planet ekzistuese më të vlefshme¹⁵.

Këta indikatorë të problemit na shpijnë në formulimin e problemit të auditimit si në vijim:

Ka indikacione që korniza e nevojshme ligjore për cilësinë e ajrit është e mangët si dhe mekanizmat e monitorimit dhe raportimit nuk janë të funksionalizuar në nivelin e duhur.

¹¹ Strategjia e Cilësisë së Ajrit (2013), Strategjia e Cilësisë së Ajrit 2013-2022, Departamenti i Mjedisit, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

¹² Agjencia Evropiane e Mjedisit, SOER 2015, Përmbledhje shteti – Ambienti Evropian – shteti dhe perspektiva 2015, <https://www.eea.europa.eu/soer-2015/countries/kosovo>

¹³ Komisioni Evropian (Bruksel, 9.11.2016, SWD(2016) 363 final), Dokument i punës së stafit të Komisionit – Raporti për Kosovën 2016

¹⁴ Komisioni Evropian (Bruksel, 9.11.2016, SWD(2016) 363 final), Dokument i punës së stafit të Komisionit – Raporti për Kosovën 2016

¹⁵ Komisioni Evropian (Bruksel, 9.11.2016, SWD(2016) 363 final), Dokument i punës së stafit të Komisionit – Raporti për Kosovën 2016

1.2 Objektiva e auditimit

Objektiva e këtij auditimi është vlerësimi i aktiviteteve të subjekteve përgjegjëse të nivelit qendror në vendosjen e kornizës ligjore si parakusht për përmirësimin e gjendjes së cilësisë së ajrit si dhe vendosjes së mekanizmave të përshtatshëm të monitorimit dhe raportimit. Objektiva e këtij auditimi është edhe vlerësimi i aktiviteteve të nivelit lokal në miratimin e planeve lokale të veprimit për cilësi të ajrit si dhe përfshirjen e tyre në menaxhimin e gjendjes së cilësisë së ajrit në nivel lokal.

1.3 Pyetjet e auditimit

Për t'iu përgjigjur objektives së auditimit ne kemi parashtruar pyetjet e auditimit si në vijim:

Niveli qendror:

1. **A ka vendosur dhe plotësuar Qeveria e Kosovës parakushtet e nevojshme ligjore për përmirësimin e cilësisë së ajrit në vend?**
2. **A monitorohet dhe raportohet statusi dhe zhvillimi i cilësisë së ajrit?**
 - 2.1 A janë vendosur stacionet për monitorimin e cilësisë së ajrit në nivel vendi dhe sa janë funksionale këto stacione?
 - 2.2 A përdoren teknika të standardizuara të matjeve të cilësisë së ajrit në stacione monitoruese?
 - 2.3 A sigurojnë stacionet monitoruese informacione të përditësuara të gjendjes së cilësisë së ajrit dhe a raportohen këto informacione në baza të rregullta?

Niveli lokal:

3. **A menaxhohet gjendja e cilësisë së ajrit në nivelet lokale, dhe nëse po, përmes cilëve mekanizma?**
 - 3.1 A kanë miratuar Komunitet planet lokale të veprimit për cilësinë e ajrit?
 - 3.2 A përpilojnë Komunitet raporte të zbatimit të planeve lokale të veprimit për cilësinë e ajrit dhe a i raportojnë këto tek subjektet përgjegjëse të nivelit qendror?
 - 3.3 A janë të përfshira Komunitet në menaxhimin e stacioneve monitoruese të cilësisë së ajrit?

1.4 Kriteret e auditimit

Kriteret e auditimit të përdorura në këtë auditim rrjedhin nga standardet ndërkombëtare¹⁶, direktivat relevante evropiane¹⁷ dhe legjislacioni kombëtar¹⁸.

Kriteret lidhur me kornizën ligjore

Për të mbrojtur shëndetin e njeriut dhe mjedisin në tërësi, është e rëndësishme që institucionet përgjegjëse në nivel lokal dhe kombëtar të luftojnë burimet e emetimeve të ndotësve të ajrit dhe të identifikojnë dhe zbatojnë masat më efektive për reduktimin e emisioneve të ndotësve të ajrit.

Emetimet e ndotësve të dëmshëm të ajrit¹⁹ duhet të shmangen, të parandalohen ose reduktohen, përmes krijimit të kornizës së nevojshme institucionale dhe ligjore si dhe përcaktimit të objektivave të duhura për ajrin e ambientit, gjithmonë duke marrë parasysh standardet, udhëzimet dhe praktikatat e mira ndërkombëtare.

Kriteret lidhur me monitorimin, vlerësimin dhe raportimin e gjendjes së cilësisë së ajrit

Institucionet përgjegjëse të nivelit lokal dhe qendror, me qëllim të reduktimit të ndotjes së ajrit dhe minimizimit të efekteve të dëmshme që ka ndotja e ajrit në shëndetin e njeriut dhe ambientit në tërësi, duhet të përmirësojnë aktivitetet e monitorimit dhe vlerësimit të ajrit duke përfshirë identifikimin e ndotësve kryesor të ajrit dhe sigurimin e informacioneve për qytetarët përmes raportimeve të rregullta të rezultateve të monitorimit dhe vlerësimit.

Cilësia e ajrit të mjedisit vlerësohet në të gjitha zonat dhe aglomeratat²⁰ në përputhje me kriteret e mëposhtme:

- *Mbrojtjen e shëndetit të njeriut*: lokacionet për monitorimin e ajrit duhet të vendosen në atë mënyrë që të sigurojnë të dhëna për zonat me përqendrimet më të larta të ndotësve të ajrit dhe ndaj të cilave popullsia ka mundësi të ekspozohet drejtpërdrejt ose tërthorazi për një periudhë të caktuar kohore. Lokacionet e monitorimit në vendet urbane duhet të jenë të vendosura në atë mënyrë që të përfshijnë kontributin e integruar të të gjitha burimeve që nënkupton se niveli i ndotjes nuk duhet të dominohet nga një burim i vetëm i ndotjes përveç nëse një situatë e tillë është tipike për një zonë më të madhe urbane. Në përcaktimin e

¹⁶ INTOSAI (2016), ISSAI 5110 - Udhëzime për kryerjen e auditimeve të performancës me një perspektivë mjedisore

¹⁷ Direktiva 2008/50/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 21 Maj 2008 mbi cilësinë e ajrit të mjedisit dhe ajrit më të pastër për Evropën

¹⁸ Strategjia e Cilësisë së Ajrit (2013), Strategjia e Cilësisë së Ajrit 2013-2022, Departamenti i Mjedisit, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor & Ligji Nr. 03/L-160 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja

¹⁹ Siç janë emetimi i dioksidit të karbonit, monoksidit të karbonit, ozonit, dioksidit të azotit, dioksidit të sulfurit, grimcave të vogla PM_{2.5} dhe PM₁₀, etj.

²⁰ Zonë ku dendësia e popullatës është mbi 250.000 banorë, ose më pak se 250.000 banorë, në një dendësi të popullsisë për km², nëse arsyetën nevojën për vlerësimin dhe menaxhimin e cilësisë së ajrit mjedisor.

lokacionit të monitorimit në sfond rural, pika e marrjes së mostrave nuk duhet të ndikohet nga aglomeratet ose ndonjë vendndodhje industriale në afërsi të saj.

- Faktorë tjerë shumë të rëndësishëm në përcaktimin e pikave monitoruese që duhet marrë parasysh janë: burimet e interferimit, siguria, qasja, disponueshmëria e energjisë elektrike dhe komunikimeve telefonike, dukshmëria e vendit në lidhje me mjedisin e tij, siguria e publikut dhe operatorëve, etj.
- Procedurat e përzgjedhjes së lokacioneve të monitorimit duhet të jenë plotësisht të dokumentuara dhe lokacionet monitoruese duhet të mbikëqyren në intervale të rregullta për të siguruar që kriteret e përzgjedhjes të mbeten të vlefshme me kalimin e kohës.

Për të siguruar që informacioni i mbledhur për cilësinë e ajrit është mjaftueshëm përfaqësues dhe i krahasueshëm në të gjithë komunitetin, është e rëndësishme që institucionet përgjegjëse për monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së ajrit të përdorin teknika të standardizuara të matjes dhe kriteret të përbashkëta për numrin dhe vendndodhjen e stacioneve matëse.

Institucionet përgjegjëse të shtetit për cilësinë e ajrit duhet të sigurojnë informacion të përditësuar për përqendrimin e ndotësve të ajrit në mjedis, të raportojë këto informacione në baza të rregullta dhe të vendosë në mënyrë rutine në dispozicion të qytetarëve.

Kriteret për përgjegjësitë dhe aktivitetet e Komunave lidhur me cilësinë e ajrit

Përgjegjësitë dhe aktivitetet e komunave lidhur me cilësinë e ajrit duhet bashkërenduar duke marrë parasysh kriteret si në vijim:

- Miratimin e planeve lokale të veprimit për cilësinë e ajrit përmes së cilave definohet menaxhimi i cilësisë së ajrit për periudhën pesë (5) vjeçare dhe veprimet përbrenda territorit të komunës, në harmoni me Strategjinë e cilësisë së ajrit.
- Planet lokale të veprimit për cilësinë e ajrit duhet të jenë pjesë integrale e planeve lokale për mjedis.
- Përpilimin e raporteve për zbatimin e planeve dhe shqyrtimin e tyre në Kuvende Komunale.
- Raportimin tek Ministria për zbatimin e këtyre planeve dhe programeve.

1.5 Fushëveprimi i auditimit

Fushëveprimi i këtij auditimi do të shtrihet në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), Agjencinë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK) në kuadër të kësaj ministrie si dhe Institutin Hidrometeorologjik të Kosovës (IHMK) në kuadër të kësaj Agjencie.

Këto institucione janë përzgjedhur për arsye se janë përgjegjëse për zhvillimin e politikave mjedisore, legjislacionin përkatës si dhe instrumentet për implementimin e këtyre politikave. Po ashtu, përgjegjësi e këtyre institucioneve është edhe mbledhja e të dhënave për mjedisin në tërësi si dhe zhvillimi dhe koordinimi i rrjetit monitorues të gjendjes së cilësisë së ajrit në Kosovë.

Meqenëse komunat kanë përgjegjësi për menaxhimin e gjendjes së cilësisë së ajrit përmes krijimit të planeve lokale të veprimit për cilësi të ajrit, dhe janë përgjegjëse për të raportuar zbatimin e masave që janë të vendosura në plane të veprimit, ne kemi përzgjedhur si raste studimi këto komuna: Prishtina, Mitrovica, Obiliqi, Hani i Elezit dhe Gjlani. Arsyet e përzgjedhjes së këtyre komunave kanë të bëjnë edhe me faktin se janë Komuna që janë më shumë të ekspozuara ndaj burimeve të ndryshme të ndotjes së ajrit. Po ashtu, në të gjitha këto komuna IHMK ka të vendosur stacione të monitorimit të cilësisë së ajrit, prandaj është e rëndësishme të shikohet bashkëpunimi i tyre dhe përfshirja e nivelit lokal në aspektin e monitorimit.

Fushëveprimi i këtij auditimi janë aktivitetet e zhvilluara gjatë viteve 2016 dhe 2017.

1.6 Metodologjia e auditimit

Metodologjia e përdorur në këtë auditim është si në vijim:

- Analizimi i kornizës ligjore dhe rregullative për përcaktimin dhe rregullimin e gjendjes së cilësisë së ajrit në dy aspekte – kompletimi dhe azhurnimi i kornizës së nevojshme legjislative dhe rregullative;
- Intervistimi i zyrtarëve përgjegjës në MMPH, AMMK dhe IHMK lidhur me statusin e kompletimit dhe azhurnimit të kornizës legjislative si dhe menaxhimin e procesit të monitorimit, vlerësimit dhe raportimit të gjendjes së cilësisë së ajrit;
- Analizimi i raporteve dhe dokumenteve tjera relevante të AMMK dhe IHMK lidhur me aspektet e monitorimit të cilësisë së ajrit – siç janë përcaktimi i stacioneve monitoruese, funksionimi i tyre, mënyra e vlerësimit dhe raportimit të të dhënave, frekuenca e raportimit të tyre, mbulueshmëria në monitorimin e zonave të ekspozuara ndaj ndotësve të ajrit të mjedisit, etj;
- Vëzhgimi i stacioneve monitoruese të gjendjes së cilësisë së ajrit në ato komuna që janë përzgjedhur si raste studimi të auditimit, si dhe krahasimi i të dhënave të raportuara në raportet e IHMK-së me situatën aktuale të këtyre stacioneve;
- Intervistimi i zyrtarëve përgjegjës të nivelit lokal, të komunave të përzgjedhura, lidhur me strategjitë dhe planet e komunës për adresimin e çështjes së cilësisë së ajrit;
- Analizimi i planeve lokale të veprimit të cilësisë së ajrit (nëse këto plane janë tashmë të miratuara nga komuna) si dhe analizimi i këtyre planeve nëse ato janë në harmoni me strategjinë e cilësisë së ajrit. Analizimi i raporteve të zbatimit të planeve të veprimit për cilësi të ajrit dhe raportimit të tyre në Ministri;
- Vlerësimi i bashkëpunimit të IHMK me komunat në të cilat gjenden stacionet monitoruese për të parë se a janë të përfshirë komunat në çfarëdo forme në procesin e monitorimit që bëjnë këto stacione dhe të dhënave që ato raportojnë.

2 Përgjegjësitë e institucioneve kryesore dhe dokumentet relevante

Sistemi aktual institucional për cilësinë e ajrit është zhvilluar nga fundi i vitit 2002. Në parim, përbëhet nga një sistem i shpërndarë i menaxhimit institucional. Institucionet e menaxhimit të mjedisit zbatojnë legjislacionin e Kosovës në fuqi dhe standardet e BE-së. Sistemi për administrimin e mjedisit përfshinë:

Kuvendin e Republikës së Kosovës - Kuvendi është institucion ligjvënës i Republikës së Kosovës i zgjedhur drejtpërdrejt nga populli. Ka dy organe të rëndësishme që merren me çështjet e mjedisit ato janë: Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Komisioni për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor.

Qeverinë e Republikës së Kosovës - Qeveria i propozon Kuvendit kornizën e nevojshme ligjore që në këtë rast kanë të bëjnë me mjedisin në tërësi si dhe cilësinë e ajrit në veçanti, merr vendime dhe nxjerr akte juridike ose rregullore të nevojshme për zbatimin e këtyre ligjeve, propozon buxhetin e nevojshëm për zbatimin e ligjeve apo rregulloreve, udhëzon dhe mbikëqyr punën e organeve të administratës, si dhe ushtron funksione të tjera ekzekutive, të cilat nuk u janë caktuar organeve të tjera të nivelit qendror ose lokal.

Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor- Mandati i Ministrisë është i përcaktuar me Rregulloren Nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive. Ka përgjegjësitë e mëposhtme në lidhje me mbrojtjen e mjedisit:

- Harton dhe ndjek zbatimin e politikave dhe programeve përkitazi me evidentimin dhe zvogëlimin e ndotjes së mjedisit; Merr pjesë në hartimin e dokumenteve strategjike; Koordinon aktivitetet për të promovuar politikën e mjedisit; Vendos norma dhe standarde dhe nxjerr udhëzime për sektorin e mbrojtjes së mjedisit, duke i respektuar standardet ndërkombëtare; Mbikëqyr zbatimin e këtyre standardeve, duke përfshirë edhe inspektimin dhe shërbimet e tjera, sipas nevojës; Menaxhon shfrytëzimin dhe zhvillimin e infrastrukturës së mjedisit; Promovon pjesëmarrjen e komunitetit, iniciativat dhe zhvillimin e aktiviteteve; Krijon politikën, zbaton ligjet dhe mbikëqyr aktivitetet për mbrojtjen e mjedisit, duke përfshirë edhe burimet ujore, ajrin, tokën dhe biodiversitetin; Nxit dhe merr pjesë në zhvillimin dhe zbatimin e fushatave të informimit publik dhe veprimtari të tjera promovuese për të rritur vetëdijësimin publik dhe pajtueshmërinë me standardet për mbrojtjen e mjedisit; Mbikëqyr dhe konstaton gjendjen e mjedisit, në veçanti ndikimin e veprimtarisë industriale, të shërbimeve publike dhe të veprimtarisë ekonomike; Krijon politikën për menaxhimin e burimeve të ujit dhe mbikëqyr zbatimin e tyre.

Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit dhe Ujerave (DMMU) është një nga departamentet e para të krijuara në kuadër të institucioneve të përkohshme. DMMU zhvillon politikën mjedisore, legjislacionin përkatës dhe instrumentet për implementimin e këtyre politikave.

Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës - siguron informacionin e duhur për administratën, Qeverinë dhe Kuvendin e Kosovës për zbatimin e politikave për mbrojtjen e mjedisit. Zhvillon dhe koordinon sistemin unik të informimit për mbrojtjen e mjedisit lidhur me sistemin e monitorimit të gjendjes së mjedisit në Kosovë si dhe mbledhë të dhënat për mjedisin;

Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës - Ndërton dhe mirëmban rrjetin themelor të stacioneve hidrologjike dhe meteorologjike. Bënë matjet dhe vrojtimit e elementeve dhe dukurive: hidrologjike, meteorologjike, biometeorologjie dhe hidrobiologjike, matjet dhe vrojtimit e elektricitetit atmosferik dhe ndotjes së ajrit, ujit, të reshurave. Sistematikisht përcjellë dhe konstaton gjendjen e cilësisë së ajrit, të reshurave atmosferike, ujërave sipërfaqësor dhe atyre nëntokësor dhe tokës, si dhe studimin dhe parashikimin e kushteve hidrometeorologjike.

Komunat - Komunat miratojnë Planet Lokale të Veprimit në Mjedis (PLVM) dhe programet për mbrojtjen e mjedisit, në përputhje me Strategjinë për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Planin e Kosovës për Veprim në Mjedis, sipas interesave specifike të saj. Në hartimin e PLVM dhe programeve, janë të inkurajuar të marrin pjesë publiku, Organizatat jo-qeveritare, organizatat profesionale dhe komuniteti i biznesit. Komunat i raportojnë Ministrisë për zbatimin e këtyre planeve dhe programeve. Për të zvogëluar ndikimet negative mbi mjedisin dhe në disa raste për të zvogëluar shpenzimet, dy ose më shumë komuna mund të zhvillojnë bashkërisht dhe miratojnë planet dhe programet e tyre.

2.1 Dokumentet relevante

Ligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja Nr. 03/L-160 i kategorizon burimet kryesore të ndotjes, vendos obligimet themelore për mbrojtjen e ajrit dhe rekomandon miratimin e vlerave kufitare të emisioneve dhe normat e cilësisë së ajrit, komfor standardeve të Bashkimit Evropian (BE) dhe OBSH. Si pjesë e programit të përgjithshëm për mbrojtjen e mjedisit, ligji në fjalë, inicion edhe përgatitjen e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Cilësinë e Ajrit, në bazë të të cilave Komunat hartojnë programet lokale për cilësinë e ajrit.

Udhëzimet Administrative (U.A) të cilat kanë dal nga ligji i lartpërmendur janë: U.A për Rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes; U.A për kontrollin e emisioneve të bashkëdyzimeve organike të avullueshme gjatë deponimit zbrazjes, mbushjes dhe transportimit të karburanteve; U.A për Kriteret për përcaktimin e pikave monitoruese, numrin dhe shpeshësinë e matjeve, klasifikimin e ndotësve të cilët monitorohen, metodologjinë e punës, formën dhe kohën e raportimit të dhënave; U.A për normat e cilësisë së ajrit; U.A për normat e lejuara të shkarkimeve në ajër nga burimet e lëvizshme të ndotjes.

Strategjia e Cilësisë së Ajrit 2013-2022 - Politikat e përcaktuara në Strategjinë e Cilësisë së Ajrit, kanë për qëllim të zhvillojnë dhe zbatojnë instrumentet e caktuara, për të ngritë cilësinë e jetës, duke siguruar bazën për përmirësim të cilësisë së ajrit, kornizë me të cilën do të arrihet mbrojtja dhe zvogëlimi i ndotjes së ajrit, në pajtim me standardet e përcaktuara të BE dhe parimet e praktikave më të mira.

3 Të gjeturat

Në këtë pjesë të raportit janë të prezantuara të gjeturat e auditimit që ndërlidhen me vendosjen e kornizës ligjore, si dhe të mekanizmave të monitorimit dhe raportimit të gjendjes së cilësisë së ajrit në Kosovë. Ky kapitull fillimisht trajton statusin e përcaktimit, azhurnimit dhe fuqizimit të parakushteve ligjore për përmirësimin e cilësisë së ajrit. Në vazhdimësi ky kapitull paraqet të gjeturat që ndërlidhen me monitorimin dhe raportimin e cilësisë së ajrit. Kjo pjesë e raportit finalizohet me të gjeturat që ndërlidhen me përgjegjësitë dhe aktivitetet e komunave lidhur me cilësinë e ajrit.

3.1 Statusi i përcaktimit, azhurnimit dhe fuqizimit të parakushteve ligjore për rregullimin e cilësisë së ajrit

Krijimi i parakushteve ligjore është më se i nevojshëm për të përcaktuar objektiva të duhura për shmangien, parandalimin dhe reduktimin e emetimeve të ndotësve të dëmshëm për ajrin. Parakushtet ligjore duhen përcaktuar duke marrë parasysh standardet, udhëzimet dhe praktikat e mira ndërkombëtare. Po ashtu, në mënyrë që të arrihet efekti i duhur është e rëndësishme që korniza që definojnë parakushtet ligjore të jetë e plotë, e përditësuar atëherë kur është e nevojshme si dhe e zbatueshme.

Përcaktimi i parakushteve ligjore për përmirësimin e cilësisë së ajrit në Kosovë karakterizohet me disa mangësi. Aktualisht korniza ligjore nuk është e kompletuar në tërësi në mënyrë që t'i përgjigjet të gjitha kërkesave që janë të nevojshme për përmirësimin e cilësisë së ajrit. Parakushtet ligjore që tashmë janë të përcaktuara nuk janë plotësisht të azhurnuara në atë mënyrë që e mundëson një implementim më të lehtë dhe më gjithëpërfshirës.

Dokumenti kyç në fushën e cilësisë së ajrit në Kosovë është Ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja. Ky ligj është i miratuar dhe shërben si dokument për rregullimin e gjendjes së cilësisë së ajrit që nga fillimi i vitit 2010, mirëpo nuk ka pësuar azhurnime apo përditësime që prej asaj periudhe. MMPH ka identifikuar se ky Ligj ka pasur nevojë për azhurnim dhe përditësim për shkak të mangësive që janë hasur gjatë implementimit të tij. Gjatë auditimit jemi informuar se për këtë ligj është përgatitur versioni i rishikuar/përditësuar, mirëpo ende nuk është dërguar në Qeveri për miratim për shkak të kërkesave për të rishikuar edhe vlerësimin e ndikimit financiar që derivon nga zbatimi i tij. Plotësim ndryshimi i këtij ligji është planifikuar të dërgohet për miratim në kuartalin e dytë të vitit 2018.

Legjislacioni sekondar është përpiluar dhe miratuar, ndërkohë që versioni i rishikuar i U.A për rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes është përgatitur dhe është paraparë të dërgohet për miratim në Qeveri në kuartalin e dytë të vitit 2018.

Nga Ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja ka dalë si obligim edhe përgatitja e Strategjisë për Cilësi të Ajrit (tash e tutje Strategjia). MMPH ka përgatitur Strategjinë për cilësi të ajrit në vitin 2013, në bashkëpunim me palët tjera relevante, dhe kjo strategji mbulon periudhën 2013-2022. Pas miratimit të kësaj Strategjie ka qenë e paraparë përgatitja e Planit të Veprimit për Cilësi të Ajrit (PVCA) me

qëllim të zbatimit të strategjisë. Një draft i PVCA i përgatitur fillimisht nga MMPH është paraparë të mbështesë zbatimin e strategjisë dhe masave të identifikuar në të gjatë periudhës 2013-2017 mirëpo një dokument i tillë nuk është miratuar dhe nuk është më relevant. Rrjedhimisht, çdo masë që mund të jetë realizuar është kryer në bazë të masave të parapara në strategji dhe jo në bazë të PVCA. Duke qenë se periudha 2013-2017 e strategjisë tashmë ka kaluar pa një plan të veprimit, aktualisht përpjekjet e MMPH kanë të bëjnë me miratimin e PVCA që pritet të mbulojë periudhën 2018-2020, pasi që nga Qeveria është rekomanduar që Planet e veprimit për implementimin e strategjisë të mbulojnë vetëm periudha 3 vjeçare. Duke qenë se tashmë ekziston një draft i PVCA 2018-2020, as ky dokument nuk është dërguar në Qeveri për miratim për shkak të kërkesave për të rishikuar vlerësimin e ndikimit financiar që rezulton nga zbatimi i masave të identifikuar në të. Gjatë auditimit është identifikuar se pavarësisht ekzistimit të një drafti të këtij plani, MMPH ka finalizuar vlerësimin e ndikimit financiar për këtë dokument, mirëpo ky dokument vazhdon të jetë i pa miratuar në Qeveri.

Në mungesë të këtyre parakushteve për zbatim të Strategjisë, MMPH ka ndërmarrë masa të përpilimit të planeve emergjente për përmirësim të cilësisë së ajrit. Në dhjetor të vitit 2016 është hartuar dhe miratuar "Plani i masave për përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe gjendjes së mjedisit në Kosovë". Ky plan është miratuar në fund të vitit 2016 dhe ka mbuluar periudhën një vjeçare, pra deri në fund të 2017. Plani është hartuar në mungesë të PVCA 2013-2017, si dhe për të iu përgjigjur gjendjes së rëndë të krijuar gjatë sezonës dimërore 2016/2017. Ky plan nuk është më valid dhe për këtë plan nuk ka raport zyrtar të MMPH të zbatimit të masave që janë paraparë në të.

Në nëntor të vitit 2017 MMPH ka hartuar dokumentin "Plani i aktiviteteve për përmirësimin e cilësisë së ajrit vjeshtë-dimër 2017-2018". Ky plan është vazhdimësi e planit paraprak emergjent 2016-2017. Gjatë analizimit të këtij plani dhe krahasimit të tij me planin paraprak emergjent është gjetur se 9 nga 12 masat e parapara për tu ndërmarrë për përmirësimin e cilësisë së ajrit janë bartur nga plani paraprak (duke qenë se nuk janë realizuar).

Më poshtë, janë të përmbledhura në një diagram mangësitë që ndërlidhen me statusin e përcaktimit, azhurnimit dhe fuqizimit të parakushteve ligjore për përmirësimin e cilësisë së ajrit:

Ligji për mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja - versioni i vjetër i rishikuar. Mungon vlerësimi i ndikimit financiar. Ende i pa miratuar.

Legjislacioni sekondar - I kompletuar, me përjashtim të versionit të rishikuar të UA për rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes i cili ka nevojë për miratim.

Strategjia për Cilësi të Ajrit (2013-2022) - E miratuar, mirëpo me mangësi në zbatim për shkak të mungesës së Planit të Veprimit.

PVCA 2013-2017 - Draft. I pa miratuar.

PVCA 2018-2020 - Draft. Ende nuk është dërguar për miratim.

Plani emergjent 2016-2017 - I miratuar. Mungon raportimi i zbatimit të masave të identifikuara në të.

Plani emergjent 2017-2018 - 9 nga 12 masat e identifikuara të bartura nga plani paraprak emergjent.

3.2 Monitorimi dhe raportimi i cilësisë së ajrit

Institucionet përgjegjëse të nivelit qendror, me qëllim të reduktimit të ndotjes së ajrit dhe minimizimit të efekteve të dëmshme që ka ndotja e ajrit në shëndetin e njeriut dhe ambientit në tërësi, duhet të përmirësojnë aktivitetet e monitorimit dhe vlerësimit të ajrit. E gjithë kjo arrihet duke siguruar informacione të përditësuara për përqendrimin e ndotësve të ajrit në mjedis, raportimin dhe vendosjen e këtyre informacioneve në dispozicion të qytetarëve në baza të rregullta, si dhe përdorimin e teknikave të standardizuara të matjes dhe kriterëve të përbashkët për numrin dhe vendndodhjen e stacioneve matëse.

Përgjegjësitë kryesore që ndërlidhen me monitorimin, informimin dhe raportimin e të dhënave për cilësi të ajrit në Kosovë i takojnë AMMK-së si dhe IHMK-së që është institut që ushtron veprimtarinë në kuadër të AMMK-së.

Ekzistojnë dy kanale përmes së cilave AMMK, me mbështetje të IHMK-së, i mbledh të dhënat e gjendjes së cilësisë së ajrit:

Të dhënat e emisioneve²¹ – këto të dhëna raportohen nga Operatorët Ekonomik (më tutje OE), veprimtaria e të cilëve është e ndërlidhur me ndotjen e ajrit. OE raportojnë në baza mujore tek AMMK lidhur me emisionet që lirohen në ajër nga veprimtaria e tyre. Zakonisht, monitorimin e gjendjes së emisioneve e bënë një kompani që kontraktohet nga vet OE. Kompania që caktohet për të bërë monitorimin e emisioneve dhe për të përpiluar raportin me të dhënat e gjeneruara, e kryen

²¹ Emision nënkupton lirim (shkarkimin) e substancave prej çfarëdo burimi në ajrin mjedisor. Në rastin e raportimit të të dhënave për emisione nga OE, çdo OP bënë raportimin e substancave që lirohen (shkarkohen) në ajër vetëm nga veprimtaria e tyre.

monitorimin përgjatë një dite të muajit që e caktojnë vet ata (kompania). Kjo metodologji rezulton në të dhëna indikative dhe jo reale, kjo pasi që dita e cila përzgjidhet nga kompania për tu bërë monitorimi mund të mos jetë përfaqësuese e gjendjes reale të emisioneve të liruara nga veprimtaria e OE.

Inspektorati në kuadër të MMPH-së është i thirrur për të bërë verifikimet e raportimeve që bëhen nga këto kompani për secilin prej OE, mirëpo ne kemi gjetur se verifikimet nuk kryhen fare pasi që puna e tyre bazohet vetëm në rishikimin e atyre raporteve që gjenerohen nga vet kompanitë, nga pajisjet për matjen e ajrit që mund të kenë vet OE dhe jo ndonjë matje që e bëjnë vet inspektorët pasi që inspektorët nuk posedojnë pajisje portabël të matjes së ajrit, sidomos për të kryer një gjë të tillë në mënyrë konstante.

Të dhënat e imisioneve²² – këto të dhëna gjenerohen nga stacionet e monitorimit të vendosura në disa lokacione nëpër Kosovë. Të dhënat që gjenerohen nga këto stacione e raportojnë gjendjen e integruar të cilësisë së ajrit që është rezultat i substancave të shkarkuara nga të gjithë ndotësit e mundshëm të ajrit. Pra, përmes këtyre të dhënave nuk mund të dihet se sa përqind e asaj gjendje është shkaktuar nga veprimtaria e operatorëve ekonomik (p.sh. termocentraleve), transporti (p.sh. lirimimi i substancave në ajër nga veturat), amvisëria (p.sh. lirimimi i substancave në ajër nga përdorimi i qymyrit nga amvisëritë për ngrohje), etj.

3.2.1 Vendosja e stacioneve të monitorimit të cilësisë së ajrit në nivel vendi

Aktualisht në Kosovë janë të vendosura 12 stacione²³ të monitorimit të cilësisë së ajrit. Tri prej këtyre stacioneve janë të vendosura në Komunën e Obiliqit – në oborrin e Qendrës së Mjekësisë Familjare, Dardhishtë – në oborrin e një shkolle fillore, dhe Palaj – tek parku i KosovaMont. Këto stacione janë të influencuara nga ndotjet që shkarkohen nga termocentrali A dhe B, trafiku, djegia e lëndëve për ngrohje, eksploatimet e minierës së thëngjillit, etj. Këto stacione i janë dhuruar Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik nga Banka Botërore, ndërkaq që kjo ministri në fund të dhjetorit 2012 i ka kaluar në pronësi të MMPH-së dhe në menaxhim të AMMK/IHMK.

Në qytetin e Prishtinës janë të vendosura dy stacione për monitorimin e cilësisë së ajrit. Njëri nga këto stacione është i vendosur në oborrin e ndërtesës së Rilindjes pasi që frekuenca e popullsisë është më e lartë, ndërkaq tjetri është i vendosur në oborrin/lokacionin e IHMK-së. Këto dy stacione janë të influencuara nga ndotësit e ndryshëm të ajrit që shkaktohen nga KEK, trafiku, djegia e lëndëve djegëse për ngrohje, etj.

Stacionet tjera janë të vendosura në: Drenas (1), Hani i Elezit (1), Mitrovicë (1), Gjilan (1), Prizren (1) dhe Pejë (1). Stacionet e vendosura në Drenas, Hani të Elezit dhe Mitrovicë janë përgjithësisht të ndikuara nga ndotjet që shkaktohen nga komplekse industriale, fabrika të çimentos apo nga erozioni i deponive të krijuara nga proceset e përpunimit të xeheve, etj. Ndërkohë që, stacionet e

²² Imision nënkupton raportimin e gjendjes së integruar të substancave që lirohen në ajrin mjedisor nga disa burime të ndotjes së ajrit (pra imisioni është paraqet gjendjen e cilësisë së ajrit që është krijuar duke marrë për substancat e shkarkuara në ajër nga termocentralet, fabrikat, transporti, amvisëria, etj.


²³ Me përjashtim të stacionit të vendosur në Brezovicë (Shterpcë) i cili është jashtë funksionit pasi që nga erërat e forta stacioni (kontejneri) ka rrëshqitë nga bazamenti dhe është dëmtuar furnizimi me rrymë elektrike.

vendosura në Pejë, Gjilan dhe Prizren janë stacione të influencuara përgjithësisht nga burimet e ndryshme të ndotjes, siç janë trafiku apo djegiet që përdoren për ngrohje.

Stacionet janë vendosur në nivel vendi, dhe ç'është më kryesorja është se janë vendosur në lokacione të cilat janë të karakterizuara me ndotje më të lartë të ajrit pasi që janë në afërsi të ndikimeve të ndotësve të ndryshëm që janë të dëmshëm për ajrin siç janë termocentralet, fabrikat, xeheroret, guoret, etj.

Figura më poshtë e tregon në mënyrë vizuale vendosjen e këtyre stacioneve në regjionin e Kosovës.

Figura 1: Lokacionet e stacioneve për monitorimin e ajrit në territorin e Kosovës



Burimi: Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, Raport vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë, 2017

3.2.1.1 Përcaktimi i lokacioneve të stacioneve monitoruese të cilësisë së ajrit

Institucionet përgjegjëse për përcaktimin e lokacioneve të stacioneve monitoruese të cilësisë së ajrit duhet të kenë parasysh një sërë kriteresh në momentin që i lokalizojnë stacionet.

Aspektet që duhet marrë parasysh në përcaktimin e lokacioneve të këtyre stacioneve përfshijnë:

- gjenerimin e të dhënave për zonat me përqendrim të larta të ndotësve të ajrit (aty ku dhe popullsia është e ekspozuar ndaj këtyre ndotësve),
- të mos jenë të pozicionuara në atë mënyrë që niveli i ndotjes të ndikohet vetëm nga një burim i caktuar i ndotjes, mirëpo nga një kontribut i integruar i të gjithë burimeve të mundshëm të ndotjes (me përjashtim të rasteve kur një burim i vetëm i ndotjes është tipik për një zonë të caktuar),
- të mbrojnë vegetacionin dhe ekosistemet natyrore, si dhe
- të marrë parasysh faktorë të rëndësishëm siç janë burimet e interferimit, siguria, qasja, disponueshmëria e energjisë elektrike dhe komunikimeve telefonike, dukshmëria e vendit në lidhje me mjedisin e tij.

Pas analizimit nga ana jonë të të dhënave dhe dokumenteve të siguruara nga AMMK dhe IHMK kemi kuptuar që bazë për përcaktimin e lokacioneve monitoruese janë marrë kriteret e dhëna në direktivën 2008/50/EC, për Cilësinë e ajrit dhe ajër të pastër në Evropë , të paraqitura në anekset III, IV dhe V të kësaj direktive dhe UA Nr.15/2010²⁴.

Përmes këtij auditimi janë identifikuar disa probleme që e kanë karakterizuar përcaktimin e lokacioneve të disa prej stacioneve të monitorimit të cilësisë së ajrit. Zyrtarët e AMMK-së/IHMK-së po ashtu pranojnë se pavarësisht të bazuarit në direktivën evropiane në momentin që janë përcaktuar lokacionet e stacioneve, ka stacione monitoruese të cilat nuk i përmbushin kriteret e vendosjes së stacionit aty ku duhet apo ashtu siç parashihet edhe me Direktiva të BE-së. Mangësitë kanë të bëjnë jo vetëm me përcaktimin e lokacionit fillestar, mirëpo edhe me dislokimin e tyre (në momentin kur është vendosur për tu kryer një gjë e tillë). Duhet theksuar se duke u nisur nga problemet e lartpërmendura, në dhjetor të vitit 2015, me iniciativë të MMPH është propozuar të bëhet “Rishikimi dhe Ridizajnimi i Rrjetit Shtetëror për Monitorimin e Cilësisë së Ajrit në Kosovë”, dhe grupi i caktuar punues nga kjo ministri ka bërë përpilimin e dokumentit për adresimin e kësaj çështjeje.

Fillimisht, probleme me përcaktimin e lokacioneve kanë pasur stacionet e monitorimit të cilësisë së ajrit në Mitrovicë dhe Gjilan.

²⁴ UA për kriteret për përcaktimin e pikave monitoruese për cilësinë e ajrit, numrin dhe shpeshtinë e matjeve, klasifikimin e matjeve, klasifikimin e ndotësve të cilët monitorohen, metodologjinë e punës, formën dhe kohën e raportimit të të dhënave.



Stacioni i monitorimit në Mitrovicë është vlerësuar se është i përshtatshëm të vendoset në lokacionin e stacionit meteorologjik të kësaj komune, mirëpo gjatë vitit 2013 ky stacion është dislokuar nga ky lokacion, pasi që ka qenë kërkesë e Komunës së Mitrovicës që lokacioni i lartpërmendur të lirohet sepse është verifikuar që është pronë private. Më tutje, IHMK ka marrë lejen e komunës për të vendosur stacionin në oborrin e shkollës fillore Eqrem Qabej pasi që është vlerësuar se ai lokacion i përmbushë kriteret e

kërkuara. Pozicioni aktual i këtij stacioni thuhet se ndodhet në afërsi të lokacionit të mëparshëm dhe se i plotëson kriteret e kërkuara sipas direktivës evropiane.

Stacioni i monitorimit të cilësisë së ajrit në Gjilan që prej prillit të vitit 2012 ka qenë i vendosur në oborr të objektit të komunës ku frekuenca e popullsisë dhe trafikut është e lartë, mirëpo, gjatë vitit 2013, komuna ka kërkuar që të largohet stacioni nga oborri i objektit të saj, dhe me këtë rast është vendosur në park të qytetit në rrugën Idriz Seferi.

Me rishikimin dhe ri-dizajnimin që i është bërë rrjetit shtetëror të monitorimit të cilësisë së ajrit është propozuar që sërish të dislokohej stacioni i Gjilanit pasi që edhe në lokacionin ku është aktualisht ky stacion ndikohet vetëm nga ndotja e ajrit që vije nga trafiku dhe jo edhe nga burimet e tjera të ndotjes. Po ashtu është propozuar edhe dislokimi i stacionit të Pejës dhe Brezovicës në vend monitorime të reja brenda lokacioneve (qyteteve) ku janë aktualisht. Njëkohësisht, është propozuar që stacioni i Brezovicës, përveç dislokimit në një lokacion tjetër duhet plotësuar me analizere të rinjë.

Gjatë auditimit kemi gjetur se stacioni i monitorimit në Pejë është dislokuar dhe procesi i dislokimit ka marrë kohë të gjatë për shkak të disa procedurave që është dashur të ndiqen, dhe aktualisht stacioni në Pejë është i vendosur tek stacioni meteorologjik i këtij qyteti. Për dislokimin e stacionit në Pejë, IHMK ka pranuar kërkesë nga drejtori i shkollës "Lidhja e Prizrenit" (në oborrin e së cilës ka qenë i vendosur stacioni) për ta larguar atë për shkak të nevojës të kësaj shkolle për të ndërtuar në afërsi të stacionit një palestër sporti. Lokacioni i stacionit monitorues i vendosur në oborr të shkollës sipas IHMK i plotëson kriteret e kërkuara mirëpo ashtu siç ishte vendosur i shkaktonte pengesë shkollës.

Propozimet për dislokimin e stacionit të Gjilanit dhe Brezovicës nuk janë realizuar ende. Shkaqet e mos realizimit janë mungesa e mjeteve buxhetore për aktivitetet që duhen kryer për të kryer dislokimin. Në mungesë të ri-dislokimit të stacionit të Gjilanit në një vend monitorim tjetër më përfaqësues brenda qytetit, është investuar në mirëmbajtje dhe servisim të stacionit për ta funksionalizuar atë, pasi që stacioni për një kohë ka qenë jashtë funksionit.


Dislokimi i stacionit të monitorimit të vendosur në Brezovicë është propozuar të bëhet për shkak të qasjes së vështirë në këtë stacion. Ne kemi kuptuar që ky stacion ka kohë që është jashtë funksionit pasi që nga erërat e forta kontejneri i stacionit ka rrëshqitur nga bazamenti dhe është dëmtuar furnizimi me rrymë elektrike. Stacioni vazhdon të jetë jashtë funksionit, dhe nuk është dislokuar

akoma për shkak të mungesës së mjeteve buxhetore dhe mungesës së gjetjes së një lokacioni të ri. Për shkak që një pjesë e analizërëve të këtij stacioni janë dislokuar në stacionin e monitorimit të cilësisë së ajrit në Drenas, ky stacion duhet plotësuar edhe me analizërë të rinjë, mirëpo një gjë e tillë nuk ka ndodhur ende.

IHMK duhet ndjekur disa hapa gjatë procesit të dislokimit, dhe zakonisht një proces i tillë merr kohë. Hapat që duhen ndjekur janë:

- hulumtimi i terrenit për përcaktimin e lokacionit të përshtatshëm për vendosjen e stacionit;
- marrja e lejeve nga Kuvendet Komunale të Komunave përkatëse për shfrytëzim të lokacionit ku vendoset stacioni;
- hulumtim për sigurimin e mjeteve financiare;
- kryerja e punimeve në ndërtimin e infrastrukturës (ndërtimi i bazamentit të stacionit, vendosja e rrethojës mbrojtëse si dhe shtrirja e kabllor për furnizim me rrymë dhe internet); si dhe
- konfigurimi i analizërëve.

Më poshtë, janë të përmbledhura në një diagram çështjet kryesore që ndërlidhen me procesin e vendosjes së lokacioneve në nivel vendi dhe procesit të dislokimit të tyre:



3.2.1.2 Gjendja funksionale e stacioneve të monitorimit të cilësisë së ajrit


Qëllim kryesor i stacioneve monitoruese është mbledhja dhe gjenerimi i të dhënave për cilësinë e ajrit në lokacione të ndryshme. Për gjenerim të të dhënave është më se e rëndësishme që stacionet monitoruese të jenë funksionale në vazhdimësi, pra të mos karakterizohen me probleme të cilat mund të pengojnë gjenerimin e të dhënave për një periudhë të caktuar kohore. Në këtë pjesë janë të paraqitur të gjeturat e auditimit që ndërlidhen me gjendjen funksionale të stacioneve gjatë vitit 2016 dhe 2017.

Për të arritur deri tek të gjetura përfaqësuese dhe të besueshme, ky auditim ndër të tjera ka marrë parasysh metodologjinë si në vijim:

- nga zyrtarët përgjegjës në IHMK janë pranuar fillimisht informatat dhe raportet përcjellëse mbi gjendjen funksionale të stacioneve; dhe
- në përpilimin e përqindjeve më poshtë, si stacione jo funksionale apo pjesërisht funksionale janë konsideruar jo vetëm ato stacione që janë karakterizuar me probleme të natyrave të

ndryshme e që kanë çuar në mos funksionim, mirëpo edhe stacionet që në bazë të raporteve vjetore (2016 dhe 2017) nuk kanë gjeneruar të dhëna.

Në diagramin më poshtë është e paraqitur në përqindje gjendja funksionale e stacioneve të monitorimit gjatë vitit 2016. Siç mund të shihet nga ky diagram, një numër shumë i vogël i stacioneve ka qenë funksional gjatë tërë vitit (17%). Pjesa dërrmuese e stacioneve ose kanë qenë pjesërisht funksional (58%) ose jashtë funksionit (25%).



Stacionet të cilat kanë qenë funksionale gjatë tërë vitit janë vetëm stacioni i vendosur në Prishtinë në oborr të IHMK-së si dhe stacioni i Drenasit. Këto dy stacione kanë gjeneruar të dhëna gjatë tërë vitit për të gjithë parametrat e ndotjes së ajrit që i posedojnë si dhe nuk kanë hasur në probleme.

Numri më i madh i stacioneve (58%, respektivisht 7 stacione) gjatë vitit 2016 kanë qenë pjesërisht funksionale për shkak të problemeve të ndryshme që i kanë karakterizuar ato. Pengesat më të vogla kanë përfshirë mos funksionimin e parametrave të caktuar të ndotjes së ajrit për një periudhë të shkurtër kohore. Probleme më të mëdha të gjendjes së stacioneve gjatë vitit 2016 janë shfaqur si rezultat i mungesës së komunikimit në mes të softverit të stacionit me datalloggerin²⁵ (regjistruetin e të dhënave), apo parametrat për matjen e cilësisë së ajrit nuk kanë komunikuar me kompjuterin/laptopin e stacionit. Në foton më poshtë janë të ilustruara secila nga këto çështje, përmes vëzhgimit të disa stacioneve monitoruese që ka bërë ekipi auditues.

²⁵ Një regjistruetin e të dhënave (gjithashtu datalogger) është një pajisje elektronike që regjistron të dhëna me kalimin e kohës përmes një instrumenti ose sensori të brendshëm ose me anë të instrumenteve dhe sensorëve të jashtëm.

Foto 2: Datallogeri (regjistruesi i të dhënave), parametrat për matjen e cilësisë së ajrit dhe PC/laptop (për mbledhjen e të dhënave të gjeneruara)




Më tutje, probleme akoma më shqetësuese që kanë ndikuar në mos funksionimin e stacioneve monitoruese kanë të bëjnë me dëmtimin apo vjedhjen e stacioneve nga faktori njeri. Stacioni i vendosur në Dardhishtë të Komunës së Obiliqit ka qenë jashtë funksionit për shkak që pjesa më vitale e stacionit është vjedhë. Ngjashëm ka ndodhur edhe me stacionin e vendosur në Mitrovicë, ku për shkak të dëmtimit që i është bërë kondicionerit të ajrit nga faktori njeri, ky stacion nuk ka gjeneruar asnjë të dhënë për vitin 2016. Nga vëzhgimi që ekipi auditues i ka bërë disa prej stacioneve monitoruese ka vënë re se përveç disa rrethojave të hekurta nuk ekzistojnë masa sigurie që do të parandalonin dëmtimin apo vjedhjen e stacioneve. I vetmi hap i ndërmarrë nga IHMK në këtë aspekt është paraqitja e rasteve në polici, mirëpo masa konkrete të sigurisë së këtyre stacioneve nuk janë ndërmarrë. Dy stacionet e tjera që nuk kanë qenë funksionale gjatë vitit 2016 janë stacioni i Pejës për shkak të propozimit për ta dislokuar, si dhe stacioni i Brezovicës për shkak të të njëjtës arsye si dhe për shkak që tre prej parametrave të këtij stacioni janë dislokuar në stacionin e Drenasit.

Sipas zyrtarëve të IHMK-së faktorët kryesor që kanë ndikuar në problemet e lartpërmendura janë mungesa e mirëmbajtjes dhe servisimit të stacioneve. Në nëntor të vitit 2016 IHMK ka nënshkruar kontratë me operatorin e përzgjedhur ekonomik për *“mirëmbajtjen e rrjetit të stacioneve për monitorimin e cilësisë së ajrit”*.

Gjatë auditimit kemi kuptuar se IHMK në mungesë të buxhetit të mjaftueshëm për servisimin e të gjitha stacioneve është detyruar të prioritzojë vetëm 4 stacione, përkatësisht stacionin e Dardhishtës, Hanit të Elezit, Drenasit dhe Mitrovicës. Arsyet e përzgjedhjes kanë të bëjnë me vlerësimin që IHMK ka bërë dhe nga i cili ka rezultuar se këto 4 stacione kanë pasur më shumë probleme gjatë periudhës kur është lidhur kontrata si dhe për shkak që lokacionet ku janë të vendosura stacionet janë zona industriale dhe paraqesin probleme në aspektin e cilësisë së ajrit. Pavarësisht mungesës së mjeteve financiare për të servisuar të gjithë stacionet, ne kemi gjetur se edhe prioritizimi i 4 stacioneve nga IHMK, në aspektin funksional nuk është bërë në mënyrë të duhur. Kjo sidomos ka të bëjë me stacionin e Drenasit i cili është prioritzuar për t’iu kryer servisimi, ndërkohë që siç mund të shihet nga diagrami më lartë, ky stacion është në mesin e 2 stacioneve që kanë qenë funksionale gjatë tërë vitit 2016. Zyrtarët e IHMK-së kanë dhënë arsyetimin se është

prioritizuar ky stacion me qëllim të sigurimit të vazhdimësisë së gjenerimit të të dhënave nga një zonë me ndotje të ajrit siç është Drenasi.

Gjendja funksionale e stacioneve monitoruese gjatë vitit 2017 është paraqitur në diagramin më poshtë, dhe siç mund të shihet nuk është se dallon shumë nga ajo e vitit 2016.



Sërish vazhdojmë të kemi një numër të lartë të stacioneve që kanë qenë pjesërisht funksionale. Vetëm 17% e stacioneve kanë qenë funksionale gjatë pjesës dërrmuese të vitit ndërkohë që 33% e stacioneve kanë qenë jashtë funksionit për më shumë se 7 muaj gjatë vitit.

Po ashtu, problemet e hasura gjatë vitit 2017 janë të ngjashme me ato të vitit 2016. Ka pasur mangësi në komunikimin e softverit me regjistruuesin e të dhënave, probleme me mosfunksionimin e kondicionerit të stacioneve, të furnizimit me rrymë, apo edhe me mungesë të internetit. Gjithashtu, ka stacione në mesin e stacioneve pjesërisht funksionale, parametrat e të cilave nuk kanë funksionuar shumë mirë për pjesën dërrmuese të vitit (siç janë Drenasi dhe Mitrovica), dhe si rezultat i këtyre problemeve këto stacione nuk kanë gjeneruar të dhëna për ata parametra për një periudhë të caktuar gjatë vitit. Rasti i dëmtimeve dhe ndërhyrjes në stacione nga faktori njeri ka qenë evident edhe gjatë vitit 2017 ku nga IHMK jemi informuar që ka pasur raste të tjera që edhe gjatë këtij viti janë paraqitur në polici dhe që pas ekzaminimit të policisë janë dërguar në prokurorinë e komunës ku gjendet stacioni.

Duhet theksuar se 33% e stacioneve që kanë qenë jashtë funksionit për më shumë se 7 muaj gjatë vitit, sipas metodologjisë së ndjekur nga ky auditim, janë ato stacione që përveç problemeve që kanë pasur, nuk kanë raportuar të dhëna për më shumë se 7 muaj gjatë vitit. Në shkurt të vitit 2017 është bërë një kërkesë tjetër nga IHMK në AMMK për servisimin e stacioneve, mirëpo kontrata për servisim nuk është finalizuar deri në qershor të vitit 2017. Kërkesa për kontratë tjetër të mirëmbajtjes dhe servisimit është bërë për të servisuar ato stacione që nuk janë përfshirë në kontratën e 2016 (pasi që siç u përmend në kontratën e nënshkruar në nëntor të 2016 është prioritetizuar servisimi i vetëm 4 stacioneve). Kontrata për servisim e finalizuar në qershor të 2017 ka arritur vlerën e rreth 150,000 Eurove. Këto mjete financiare kanë qenë shumë më të mjaftueshme për servisimin e stacioneve në krahasim me ato të kontratës së lidhur në nëntor 2016 (rreth 60,000 euro). Të gjitha stacionet që kanë

pasur nevojë për mirëmbajtje/servisim janë servisuar mirëpo një gjë e tillë është finalizuar nga fundi i vitit 2017. Duhet kuptuar që edhe servisimi është ndër arsyet e tjera se pse një numër i konsiderueshëm i stacioneve nuk ka gjeneruar të dhëna (pasi që në momentin e dërgimit për servisim të gjithë apo numri i caktuar i parametrave që është duke u servisuar është jashtë funksionit).

3.2.2 Teknikat e matjes, mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave të cilësisë së ajrit

Përdorimi i teknikave të standardizuara të matjes të cilësisë së ajrit është më se i domosdoshëm për të siguruar që informacioni i mbledhur për cilësinë e ajrit është mjaftueshëm përfaqësues dhe i krahasueshëm në të gjithë komunitetin.

Pjesa dërmuese e stacioneve monitoruese kanë të instaluar analizërë/parametra që masin nivelin e ndotjes së ajrit me NO₂, SO₂, CO, O₃, PM₁₀ dhe PM_{2.5} (Shih për më shumë Shtojcën 1).²⁶ Pra teknika për matjen e cilësisë së ajrit nëpër stacione është e standardizuar për sa i përket plotësisë të këtyre stacioneve me numrin dhe llojin e njëjtë të parametrave. Siç u përmend edhe më herët, stacioni i vendosur në Brezovicë aktualisht nuk është i funksionalizuar me parametrat e nevojshëm pasi që ende nuk është dislokuar. Për stacionin në Pejë është propozuar që të vazhdohet me metodën indikative²⁷, pra të monitorohen në vazhdimësi parametrat që kanë rezultuar problematik e që janë PM₁₀ dhe PM_{2.5}. Po ashtu, nga stacioni i Pejës janë dislokuar tek stacioni i Mitrovicës dy parametra (ai i SO₂ dhe O₃) pasi që është konsideruar e nevojshme një gjë e tillë.

Përveç asaj që u elaborua më lartë, se një pjesë e këtyre parametrave mund të mos jenë funksionale për një periudhë të caktuar kohore si rezultat i dëmtimeve, prishjeve apo thjeshtë mungesës së servisimit, e rëndësishme është që stacionet i posedojnë këto parametra. Pavarësisht aspektit të matjes së cilësisë së ajrit që është i standardizuar në pjesën më të madhe të stacioneve, ne kemi gjetur se ekzistojnë probleme të ndryshme sa i përket mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave që gjenerohen nga këto matje.

Aktualisht janë vetëm tri stacione që janë të lidhura përmes një softveri lokal. Stacionet e vendosura në lokacionet: Obiliq/QMF, Obiliq/Dardhishtë dhe Obiliq/Palaj janë stacione të cilat transferojnë të dhëna në softverin lokal të vendosur në IHMK, por ky softver nuk ka opsionet për përpunimin e të dhënave dhe gjenerim të raporteve. Nga ky softver IHMK-së i mundësohet marrja e të dhënave dhe monitorimi nga distanca i gjendjes funksionale të parametrave të vendosur në to. Të dhënat nga stacionet tjera monitoruese mblidhen me USB nga zyrtarët e IHMK-së, që nënkupton se zyrtarët e IHMK-së duhet shkuar fizikisht në lokacionin ku janë të vendosura stacionet. Të dhënat e

²⁶NO₂ – dioksidi i azotit; SO₂ – dioksidi i sulfurit; CO – monoksidi i karbonit; O₃ – ozoni; PM₁₀ dhe PM_{2.5} – grimcat e imëta. Përderisa të gjithë parametrat janë të dëmshëm për shëndetin tonë, grimcat e imëta PM₁₀ dhe PM_{2.5} janë shumë të dëmshme dhe kjo për faktin që edhe si parametra janë më shumë të shfaqura në vendin tonë. PM_{2.5} përbëhet nga grimca me diametra që janë më pak ose të barabartë me madhësinë 2.5 mikronë. PM_{2.5} është një shqetësim akoma më serioz për shëndetin se sa PM₁₀, pasi grimcat më të vogla mund të udhëtojnë më thellë në mushkëritë tona dhe të shkaktojnë më shumë efekte të dëmshme.

²⁷ Instalohen pajisje semi-automatike dhe mostrim pasiv i vetëm disa ndotësve, që në rastin e Pejës janë monitorimi i PM₁₀ dhe PM_{2.5}. Metoda indikative po ashtu nënkupton që raportohen vetëm këta parametra dhe jo gjatë tërë vitit.

mbledhura përpunohen para se të raportohen për publikun. Procesi i përpunimit të të dhënave zgjatë shumë pasi që deri më tani në IHMK kjo gjë është realizuar nga një zyrtarë i vetëm, si dhe të dhënat duhen përpunuar individualisht në Excel pa mbështetjen e ndonjë programi apo sistemi të avancuar që e bënë përpunimin e tyre.

Zyrtarët e IHMK-së duhet të aplikojnë disa hapa gjatë procesit të përpunimit të të dhënave. Në momentin që merren të dhënat me USB nga stacionet, zyrtarët duhet të konvertojnë formatin e pranuar të të dhënave në formatin e aplikueshëm në Excel dhe më pas e bëjnë kontrollimin e secilës të dhënë të raportuar.

Specifikisht për të bërë përpunimin e të dhënave duhet bërë:

- validimi i të dhënave;
- identifikimi i vlerave të momentit të cilat mund të jenë raportuar gabimisht apo edhe i vlerave të veçuara që nuk janë relevante për parametrin nga i cili gjenerohen; si dhe
- kontrollimi një për një i vlerave të identifikuara.

Numri i madh i të dhënave që pranohen dhe që duhet përpunuar vetëm nga një zyrtar në IHMK ka shkakuar vonesa në përditësimin e të dhënave, në gjenerim të raporteve dhe rrjedhimisht në publikimin e tyre në kohë për publikun. Nga zyrtarët e IHMK-së u sqarua se përafërsisht për një periudhë një mujore mblidhen rreth 1400 vlera për një parametër dhe këto vlera duhet të kontrollohen dhe në mënyrë që të gjenerohen raporte mujore, zyrtarët fillimisht duhen përpunuar këto të dhëna për orë e pastaj për ditë dhe së fundmi për muaj. Metoda manuale e përpunimit të të dhënave e rritë mundësinë e gabimeve në prezantimin e të dhënave të sakta.

Prej muajit qershor të vitit 2017, IHMK ka angazhuar tre zyrtarë për të mbledhur të dhënat nga secili prej stacioneve. Sipas informatave të pranuar në IHMK, zyrtarët bëjnë mbledhjen e të dhënave dy herë në muaj.

Më poshtë janë të përmbledhura të gjeturat kryesore që ndërlidhen me teknikat e matjes, mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave të cilësisë së ajrit:



Të gjitha stacionet janë të pajisura me numër dhe lloj të njejtë të parametrave kryesor që bëjnë përcaktimin e ndotjes së ajrit me NO_2 , CO , SO_2 , O_3 , PM_{10} dhe $\text{PM}_{2.5}$. Teknikat e matjes janë të standardizuara.



Mbledhja e të dhënave bëhet manualisht (me përjashtim të tre stacioneve të vendosura në Obiliq) përmes USB nga zyrtarët e IHMK-së. Mbledhja e të dhënave nëpër stacione bëhet minimumi dy herë në muaj.




Në mungesë të një sistemi qendror i cili do bënte mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave në mënyrë automatike, si dhe gjenerimin e raporteve, të dhënat aktualisht përpunohen një nga një nga zyrtarët e IHMK-së. Proces që merr shumë kohë dhe që shkakton vonesa në raportim.

3.2.3 Raportimi i të dhënave të cilësisë së ajrit


Procesi i raportimit të të dhënave ishte përcjellur me mangësi të shumta të cilat kishin të bënin me plotësinë e të dhënave në raportet e publikuara nga IHMK. Ka disa stacione monitorimi që nuk kanë raportuar të dhëna për disa prej parametrave të cilësisë së ajrit. Diagramet më poshtë tregojnë gjetjet e auditimit lidhur me plotësinë e të dhënave të raportuara në vitin 2016 dhe 2017. Në veçanti, analiza e kryer tregon numrin e muajve pa të dhëna të raportuara në secilin prej stacioneve monitoruese në Kosovë gjatë vitit 2016 dhe 2017.

Viti 2016 është karakterizuar me mangësi të mëdha në raportimin e të dhënave, si rezultat i problemeve që u shtjelluan më lartë siç ishin mungesa e mirëmbajtjes apo servisimit të stacioneve, dëmtimi i tyre, vonesat në mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave, etj.

Siç mund të vihet re nga diagrami më poshtë, dy prej stacioneve të monitorimit nuk kanë raportuar të dhëna për asnjërin prej parametrave gjatë tërë vitit si rezultat i mosfunksionimit të tyre. Shqetësues është po ashtu fakti se mungesa e raportimit të të dhënave ka qenë evidente gjatë pjesës më të madhe të vitit edhe për pjesën tjetër të stacioneve (me përjashtim të Drenasit dhe stacionit të vendosur në IHMK që kanë një gjendje të raportimit më të mirë). Akoma më problematik është fakti që parametrat më problematik të ndotjes së ajrit në vendin tonë, PM₁₀ dhe PM_{2.5}, nuk kanë të dhëna të raportuara për më shumë se gjashtë muaj në 6 prej 11 stacioneve të paraqitura në diagram.




Gjatë vitit 2017 vihet re një përmirësim sa i përket gjendjes së plotësisë së të dhënave të raportuara nga IHMK. Pavarësisht këtij përmirësimi, ka pasur mangësi në raportim në pjesën dërrmuese të stacioneve.



Ajo që është shqetësuese gjatë vitit 2017 është fakti se ka ende stacione të monitorimit të cilat janë të vendosura në zona që karakterizohen me ndotje të lartë të ajrit (siç janë Palaj në Obiliq, Hani i Elezit, Gjiilani) të cilët kanë pasur mungesë të të dhënave për disa prej parametrave më shumë 6 muaj gjatë vitit. Stacioni i vendosur në Palaj të Obiliqit është i rëndësishëm për të pasur të dhëna të raportuara gjatë tërë vitit pasi që gjendet në një afërsi të madhe me ndotësin e ajrit Termocentralin B. Ndërkohë që si gjatë vitit 2016, ashtu edhe gjatë vitit 2017, ky stacion është karakterizuar me mangësi të mëdha në raportim të të dhënave. Në foton më poshtë është paraqitur afërsia që stacioni monitorues në Palaj të Obiliqit ka me Termocentralin B.



Diagrami më poshtë tregon analizën e kryer duke u bazuar në mangësitë në raportimin e të dhënave sipas parametrave të vendosur në stacione monitorimi.



Mund të vihet re që ka përmirësime në raportimin e parametrave nga viti 2016 në 2017 (me përjashtim të raportimit të SO₂ ku dallimi është shumë i vogël). Gjithsesi, parametrat që siç u cek më herët janë problematik dhe evident në vendin tonë, PM₁₀ dhe PM_{2.5}, nuk janë raportuar mesatarisht 4.2 muaj gjatë vitit 2017, që nuk është pak veçanërisht nëse janë muaj të dimrit (muaj kur këta parametra arrijnë vlera maksimale).

Në bazë të analizimit të dokumenteve, si dhe nga takimet e mbajtura me zyrtarët përgjegjës të IHMK, kemi identifikuar se cilët janë muajt kritik sa i përket ndotjes së ajrit. Periudha gjatë së cilës ajri është më i ndotur (rrjedhimisht edhe vlerat e parametrave regjistrojnë tejkalime të mëdha) përfshinë muajt Shtator – Mars (pra përgjithësisht muajt e dimrit). Gjatë takimeve që kemi mbajtur me zyrtarë të IHMK jemi informuar që ky institut gjatë periudhës së ndotjes alarmante të ajrit mobilizohet për ngritjen e kapaciteteve në monitorim dhe raportim. IHMK po ashtu deklaroi se si rezultat i mobilizimit gjatë këtyre muajve ata përgatisin raporte ditore dhe ato i publikojnë në ueb faqen zyrtare të AMMK.


Pavarësisht këtyre deklaratave të IHMK-së ne kemi identifikuar mangësitë si në vijim:

- Gjatë vitit 2017, stacioni i monitorimit në Pejë, Prizren, Han të Elezit, Gjilan dhe Palaj (Obiliq) nuk kanë asnjë të dhënë të raportuar për PM₁₀ dhe PM_{2.5} gjatë muajve kritik janar, shkurt dhe mars;
- Dy stacionet e monitorimit në Prishtinë si dhe stacioni në Han të Elezit nuk kanë të dhëna të raportuara për PM₁₀ dhe PM_{2.5} gjatë muajit shtator;
- Nuk ka raportim të të dhënave për cilësi të ajrit në kohë reale;
- IHMK duke filluar nga gjysma e tetorit të vitit 2017 e bënë raportimin në baza ditore vetëm për dy stacionet e vendosura në Prishtinë, ndërkaq që për tri stacionet e vendosura në Obiliq ka filluar me raportime ditore prej datës 12 Janar 2018. Raportohen vetëm grimcat e imëta PM₁₀ dhe PM_{2.5}.

3.2.3.1 Tejkalimet e vlerave të lejuara të grimcave PM₁₀ dhe PM_{2.5} gjatë vitit 2016/2017

Duke u nisur nga gjendja alarmante e krijuar në vend në lidhje me ndotjen e ajrit është e rëndësishme të paraqesim tejkalmimet e vlerave të lejuara gjatë vitit të parametrin PM₁₀ si dhe vlerat maksimale që janë arritur të parametrin PM_{2.5}. Duke u nisur nga të gjeturat paraprake, që raportimi i të dhënave nuk ka qenë i plotë për të gjitha stacionet si dhe për një pjesë të konsiderueshme të vitit 2016 dhe 2017, tejkalmimet e vlerave të paraqitura në këtë pjesë të raportit janë të bazuara vetëm në ato të dhëna që janë raportuar (pra ekziston mundësia që tejkalmimet të jenë akoma më të larta, gjithmonë nëse raportimi i të dhënave do të ishte i plotë dhe do të shihej pasqyra e përgjithshme e tejkalimeve të vlerave nëpër stacione).

Sipas raporteve të IHMK, që në fakt janë të bazuara edhe në kriteret e përcaktuara në direktiva evropiane, vlera limite/e lejuar për 24 orë, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut për parametrin PM₁₀ është 50 µg/m³²⁸, dhe numri maksimal i tejkalimeve të lejuara brenda vitit është 35 ditë. Sa i përket parametrin PM_{2.5}, vlera limite/e lejuar vjetore, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut është 40 µg/m³, ndërkohë që numri maksimal i tejkalimeve të lejuara brenda vitit nuk parashihet. Për qëllime të këtij auditimi, më poshtë do të paraqesim ditët me tejkalime brenda vitit për ato stacione që kanë pasur tejkalime për parametrin PM₁₀, ndërkohë që për parametrin PM_{2.5} (duke qenë se nuk parashihet numri maksimal i tejkalimeve gjatë vitit) do të paraqesim vlerat maksimale të regjistruara gjatë vitit.




Stacioni me më së shumti ditë me tejkalime të PM₁₀ gjatë vitit 2016 ka qenë ai i Obiliqit, në të cilin janë regjistruar 93 ditë me tejkalime të vlerave të PM₁₀. Krahasuar me 35 ditë sa është maksimumi i ditëve të lejuara brenda vitit, numri i ditëve të


regjistruara me tejkalime të këtij parametri në stacionin e Obiliqit është tejkaluar për 165%, apo 58 ditë me tejkalime më shumë se nga ç 'lejohet. Gjatë vitit 2017, stacioni që ka regjistruar më së shumti tejkalime të vlerave të PM₁₀ është ai i Drenasit, në të cilin vlerat e PM₁₀ janë tejkaluar 68 ditë brenda vitit, apo 33 ditë mbi vlerat e lejuara për ditë me tejkalime. Stacion po ashtu me shumë tejkalime brenda vitit 2016 dhe 2017 është edhe ai i Prishtinës i vendosur në oborrin e IHMK-së, në të cilin gjatë 2016 vlerat e PM₁₀ janë tejkaluar 53 ditë apo 51 % më shumë se ç 'lejohet ndërkohë që gjatë 2017

²⁸ Njësia matëse e parametrin PM₁₀ është mikrogram për metër kub.

këto vlera janë tejkaluar gjatë 61 ditëve brenda vitit apo 74% më shumë se vlera e lejuar. Stacione të tjera që kanë pasur tejkalime janë edhe ai i Prishtinës (tek Rilindja) dhe stacioni i vendosur në Gjilan.



Në bazë të analizimit të raportimit të të dhënave përgjatë dy viteve, kemi gjetur se ka pasur disa raste kur vlerat e regjistruara të PM₁₀ (duke u bazuar në mesataren ditore) kanë tejkaluar vlerën e lejuar prej 50 µg/m³ më shumë se 400%, që në fakt është shumë shqetësuese kur kemi parasysh ndikimin që ky parametër ka në shëndetin e njeriut. Stacionet e monitorimit në të cilat janë regjistruar vlerat maksimale gjatë vitit 2016 janë ai i Obiliqit (291.67) dhe Prishtinës tek IHMK-ja (213). Ndërkohë që në vitin 2017, stacioni me vlerën maksimale më të lartë të PM₁₀ është stacioni i monitorimit në Dardhishtë të komunës së Obiliqit (326.6), i përcjellë nga ai i Gjilanit (292.8) dhe Prishtinës tek IHMK-ja (254.9).



Grimcat e imëta PM_{2.5} sikurse u përmend edhe më herët në raport, janë shumë të rrezikshme për shëndetin e njeriut pasi që janë grimca me një diametër shumë të vogël dhe si të tilla mund të udhëtojnë më thellë në mushkëritë tona dhe të shkaktojnë efekte të dëmshme.

Në bazë të të dhënave të raportuara, del që vlerat maksimale të PM_{2.5} përgjatë një orë kanë arritur nivele jashtëzakonisht të larta dhe një gjë e tillë është akoma më alarmante sa i përket shëndetit të

njeriut. Përderisa vlera kufitare e lejuar e $PM_{2.5}$ është $40 \mu\text{g}/\text{m}^3$, gjatë vitit 2016 vlera më e lartë është vërejtur në stacionin e monitorimit të Obiliqit (345.9). Vlera po ashtu të larta të $PM_{2.5}$ janë regjistruar gjatë vitit 2016 edhe në stacionet e monitorimit të Prishtinës tek IHMK-ja (156) dhe Drenasit (130.4). Gjatë vitit 2017 janë regjistruar vlera maksimale të $PM_{2.5}$ akoma më shqetësuese se në vitin paraprak. Të dhënat e regjistruara nga stacioni i monitorimit në Prishtinë tek IHMK-ja kanë treguar që përgjatë një ore vlerat e $PM_{2.5}$ kanë arritur vlerën 412. Vlera të tjera të larta të $PM_{2.5}$ gjatë vitit 2017 janë regjistruar edhe në stacionin e monitorimit në Dardhishtë të komunës së Obiliqit (342.8) dhe Drenas (266.5).

Tejkalimet e vlerave të PM_{10} dhe $PM_{2.5}$ të paraqitura në diagram, si për 2016 ashtu edhe për 2017, janë regjistruar gjatë periudhës Nëntor-Janar.

3.3 Roli dhe menaxhimi i cilësisë së ajrit në nivel lokal

Përgjegjësi kryesore e komunave në relacion me cilësinë e ajrit është miratimi i planeve lokale të veprimit për mjedis (PLVM) përmes së cilave definojnë politikat dhe menaxhimi i cilësisë së ajrit për periudha pesë vjeçare, si dhe veprimet përbrenda territorit të komunës, në harmoni me Strategjinë e cilësisë së ajrit. Planet lokale të veprimit për cilësi të ajrit janë pjesë integrale e PLVM-ve. Raporti për zbatimin e planit shqyrtohet nga kuvendet komunale dhe komunat e kanë për obligim që të raportojnë tek Ministria për zbatimin e këtyre planeve dhe programeve.

3.3.1 Miratimi i planeve lokale të veprimit në mjedis

Në tabelën më poshtë janë të përmbledhura të gjeturat e këtij auditimi lidhur me miratimin e PLVM-ve në komunat e përzgjedhura si raste studimi, përpilimi i raporteve të zbatimit të këtyre planeve, raportimi i tyre në Ministri, si dhe statusi i vlefshmërisë së PLVM-ve aktuale nëpër komuna.

Komuna	A kanë miratuar Komunat planet lokale të veprimit për mjedis?	A përpilojnë Komunat raporte të zbatimit të planeve lokale të veprimit për mjedis?	A raportojnë Komunat për zbatimin e planeve të veprimit apo për gjendjen e cilësisë së ajrit në MMPH?	Në rastin kur Komuna ka miratuar Planin Lokal të Veprimit për mjedis, a është plani ende i vlefshëm?
Prishtinë	JO	JO	PO	JO
Obiliq	PO	JO	Baza ad-hoc	JO (2012-2017)
Mitrovicë	PO	PO	Baza ad-hoc	JO (2011-2016)
Hani i Elezit	PO	PO	Baza ad-hoc	JO (2012-2017)
Gjilan	PO	JO	JO	JO (2009-2015)

Të gjitha komunat e lartpërmendura kanë miratuar PLVM-të me përjashtim të komunës së Prishtinës. PLVM-të e miratuara kanë të përfshirë brenda tyre PLVCA-të. PLVM e komunës së Prishtinës është dokument i hartuar nga komuna me financimin e GiZ, mirëpo ende vazhdon të ketë statusin e draft dokumentit pasi që nuk është miratuar në kuvend komunal. PLVM e Prishtinës që aktualisht është draft mbulon periudhën 2016-2020, ndërkohë që as para kësaj periudhë kjo komunë nuk ka pasur plan të miratuar për mjedis/cilësi të ajrit.

3.3.1.1 Përpilimi i raporteve të zbatimit të planeve lokale të veprimit në mjedis

Një problematikë lidhur me PLVM-të aktuale të komunave është se në masë të madhe nuk përpilohen raporte të zbatimit të aktiviteteve që janë të parapara për tu ndërmarrë në këto plane, sidomos ato aktivitete që ndërlidhen me përmirësimin e ndotjes së ajrit. Komunat që nuk kanë përpiluar raporte të zbatimit të PLVM-ve janë ajo e Prishtinës, Obiliqit dhe Gjilanit. Komunat e Mitrovicës dhe Hanit të Elezit kanë përpiluar raporte të zbatimit të PLVM-ve. Arsyeja që ka shtyrë komunat të përpilojnë raportet e zbatimit të masave të PLVM-ve është kryesisht rezultat i kërkesave

të parashtruara nga REC²⁹. Duhet theksuar se REC po ashtu ka mbështetur komunat në përpilimin e PLVM-ve.

Në PLVM-të e komunave janë identifikuar disa fusha kryesore të përmirësimit të mjedisit, dhe janë paraparë një numër i masave për të adresuar ato fusha. Më poshtë janë të paraqitura gjetjet kryesore të këtij auditimit lidhur me fushat e prioritizuara nga komunat e audituara në PLVM-të e tyre:

- Në PLVM të komunës së Obiliqit janë identifikuar 5 prioritete mjedisore. Prioriteti i parë mjedisor është ndotja e ajrit dhe në kuadër të kësaj fushe janë identifikuar 5 probleme, ndërkaq për ti adresuar këto probleme janë planifikuar të ndërmerren 17 masa.
- Në PLVM të komunës së Gjilanit janë identifikuar 3 prioritete mjedisore. Ndotja e ajrit nuk figuron në mesin e prioriteteve të identifikuara në PLVM të kësaj komune.
- Në PLVM të komunës së Prishtinës janë identifikuar 8 prioritete mjedisore. Prioritet kryesor në PLVM të kësaj komunë i jepet ndotjes së ajrit. Në kuadër të ndotjes së ajrit janë identifikuar 3 probleme, ndërkohë që për ti adresuar këto probleme janë planifikuar të ndërmerren 11 masa. Përderisa komuna vazhdon të jetë me PLVM jo të miratuar, çdo masë e ndërmarrë realizohet në baza ad-hoc.
- Në PLVM të komunës së Hanit të Elezit janë identifikuar 4 prioritete mjedisore. Edhe kjo komunë i ka dhënë prioritet kryesor menaxhimit të cilësisë së ajrit. Në kuadër të kësaj fushe janë identifikuar 3 probleme, ndërkohë që për të adresuar këto probleme janë identifikuar 9 masa.
- Në PLVM të Mitrovicës janë identifikuar 6 prioritete mjedisore, ku po ashtu prioritet kryesor i është dhënë çështjes së cilësisë së ajrit. Për të adresuar problemet e ndotjes së ajrit në këtë komunë janë identifikuar 2 masa.

3.3.1.2 Vlefshmëria e planeve lokale të veprimit në mjedis

Duke qenë se PLVM-të përfshijnë kryesisht periudhë pesë vjeçare të implementimit, një problem që e karakterizon nivelin lokal është edhe vlefshmëria e PLVM-ve aktuale. Të gjitha PLVM-të e komunave të përzgjedhura si raste studimi janë aktualisht jo të vlefshme. PLVM e komunës së Obiliqit dhe Hanit të Elezit ishin të vlefshme deri në fund të vitit 2017. PLVM e Mitrovicës ka qenë e vlefshme deri në fund të vitit 2016, ndërkohë që ajo e Gjilanit vetëm deri në vitin 2015. Çështje për tu brengosur përveç mungesës në masë të madhe të përpilimit të raporteve të zbatimit të këtyre planeve, është edhe mungesa e aktiviteteve për të përtërirë këto plane për një periudhë tjetër kohore. Kjo vlen sidomos për komunën e Gjilanit dhe Mitrovicës, PLVM-të e së cilave kanë kohë që nuk janë të vlefshme. Arsyetimi kryesor i përdorur nga komunat si për mos përtëritjen e planeve, si për mungesën e implementimit të disa prej masave të parapara në plane, është mungesa e buxhetit. Në këtë aspekt, komunave pritet tu dalë në mbështetje REC, pasi që një organizatë e tillë siç u cek më herët u ka dalë në ndihmë komunave për përpilimin e PLVM-ve fillestare.

²⁹ Qendra Rajonale e Mjedisit për Evropën Qendrore dhe Lindore, Zyra në Kosovë

3.3.2 Raportimi i komunave në Ministri

Çështje problematike është edhe mungesa e raportimit të rregullt të komunave në ministri. Komuna e Prishtinës, pavarësisht mungesës së një PLVM-je të miratuar, raporton në baza të rregullta në MMPH për gjendjen e cilësisë së ajrit në përgjithësi, apo të ndonjë aktiviteti të realizuar në këtë drejtim (edhe nëse aktivitetet e tilla janë të realizuara në baza ad-hoc). Në baza ad-hoc, dhe atë rrallë herë, raportojnë komunat e Obiliqit, Mitrovicës dhe Hanit të Elezit. Ndërkohë, që komuna e Gjilanit është deklaruar se nuk raporton në MMPH. Arsyet e këtyre ngecjeve në raportim i atribuohen mungesës së përgjegjshmërisë dhe vullnetit nga ana e komunave, mirëpo edhe mungesës së kërkesave për raportim nga ana e MMPH-së.

3.3.3 Bashkëpunimi në mes të nivelit lokal dhe qendror

Po ashtu kishte mungesë të bashkëpunimit në mes të nivelit qendror dhe atij lokal në menaxhimin e cilësisë së ajrit. Duke qenë se stacionet monitoruese që i elaboruam më lartë janë të vendosura në të gjitha komunat që kanë qenë pjesë e këtij auditimi, ne kemi gjetur se përgjithësisht këto komuna nuk kanë asnjë qasje në këto stacione, dhe nuk janë të përfshira nga IHMK në asnjë mënyrë në menaxhimin e stacioneve, pasi menaxhimi me këto stacione është i centralizuar.

Komunat informohen për të dhënat e cilësisë së ajrit që gjenerohen nga stacionet monitoruese të vendosura në territorin e tyre, përmes raporteve që publikohen në uebfaqen e IHMK-së. Edhe në këtë rast janë identifikuar mangësi. Ka pasur raste kur në uebfaqen e IHMK-së nuk ka pasur raportim fare për periudhën Janar-Gusht 2017 për gjendjen e cilësisë së ajrit në komunën e Obiliqit (pra nuk janë raportuar të dhënat e stacioneve monitoruese në Obiliq, Dardhishtë dhe Palaj). Lidhur me këtë zyrtari i mjedisit i kësaj komune i është drejtuar IHMK-së me një email përmes së cilit ka kërkuar të dhënat e stacioneve monitoruese për Obiliq. Emaili është dërguar me 9 tetor 2017, mirëpo gjatë periudhës sa është kryer ky auditim (nëntor 2017) kemi vënë re se komuna nuk kishte pranuar përgjigje për këtë çështje. Reflektimi për publikim të raporteve mujore për Obiliq është realizuar në momentin që kjo çështje është adresuar nga ne gjatë auditimit të IHMK-së. Arsyetimi i përdorur nga zyrtarët e IHMK-së për këtë çështje ka pasur të bëjë me angazhimet e shumta si dhe mungesën e zyrtarëve për të bërë përpunimin e të dhënave në kohë.

E vetmja komunë që ka ndërmarrë iniciativë për të bërë monitorim vetanak të cilësisë së ajrit është ajo e Prishtinës. Kjo komunë me vet-iniciativë dhe me donacionin që ka pranuar, ka bërë instalimin e gjashtë pajisjeve monitoruese. Katër prej tyre janë vendosur në brendësi të lagjeve ndërsa dy të tjera janë vendosur në rrugët e ngarkuara. Qëllimi i këtyre pajisjeve monitoruese është paraqitja e gjendjes së cilësisë së ajrit në rrugët kryesore dhe si ato mund të ndryshojnë në brendësi të lagjeve. Nëse i krahasojmë këto pajisje me stacionet e monitorimit të ajrit në nivel nacional të menaxhuara nga IHMK, këto pajisje ndër të tjera, nga parametrat e rëndësishëm për vendin tonë, masin grimcat PM_{2.5}, ndërkohë që nuk bëjnë matjen e grimcave PM₁₀. Komuna nuk ka qasje të drejtpërdrejtë në të dhënat që gjenerohen nga gjashtë pikat monitoruese. Të dhënat në baza mujore raportohen tek Komuna nga kompania që është e kontraktuar. Komuna nuk bënë verifikim të të dhënave që raportohen, dhe bazohet vetëm në ato të dhëna që raportohen nga Kompania (kompania e kontraktuar në këtë rast është përgjegjëse për interpretim të të dhënave, raportimin e tyre si dhe

mirëmbajtjen e pikave monitoruese). Mangësi e identifikuar gjatë këtij auditimi është edhe mungesa e koordinimit në mes të komunës së Prishtinës dhe IHMK lidhur me të dhënat për cilësinë e ajrit që raportohen nga pikat monitoruese të vendosura nga vet komuna si dhe dy stacionet monitoruese që menaxhohen nga IHMK. Të dhënat që raportohen nga dy anët e pikave monitoruese kanë rezultuar shpesh herë të jenë të ndryshme, dhe si të tilla kanë shkaktuar konfuzitet në mesin e qytetarëve.

Burime të mëdha të ndotjes së ajrit, siç janë termocentralet e KEK dhe fabrika e Sharrcem, janë të pozicionuara në komunën e Obiliqit dhe të Hanit të Elezit. Lidhur me këtë, komuna e Obiliqit dhe ajo e Hanit të Elezit kanë treguar dhe dëshmuar me dokumente të ndryshme që kanë bërë disa herë kërkesa, vërejtje dhe presion tek këta ndotës të ajrit, mirëpo ato tregojnë që në këtë aspekt nuk kanë arritur rezultate pasi që shpesh herë kërkesat e tyre janë shpërfillur, dhe gjendja ka vazhduar të jetë e njëjtë.

4 Konkluzionet

Ky auditim, në bazë të analizimit të detajuar të të gjitha të dhënave dhe informatave të pranuar nga entitetet përgjegjëse ka ardhur në konkluzionin se menaxhimi i gjendjes së cilësisë së ajrit në Kosovë është jo efikas pasi që karakterizohet nga mangësi të shumta. Gjendja e cilësisë së ajrit në Kosovë nuk është e mbështetur dhe e fuqizuar plotësisht nga korniza e nevojshme ligjore, si dhe sistemi i monitorimit dhe raportimit nuk është plotësisht funksional. Po ashtu, në nivel lokal ekzistojnë parregullsi të ndryshme në miratimin e planeve lokale për mjedis, në raportimin e zbatimit të këtyre planeve si dhe në përtëritjen e planeve në momentin kur ato nuk janë të vlefshme.

Mungesa e kompletimit dhe azhurnimit të kornizës ligjore si parakusht kryesor për përmirësimin e cilësisë së ajrit

Duke qenë se korniza ligjore është parakusht për rregullimin e sistemit të përgjithshëm të përgjegjësi dhe veprimeve për cilësinë e ajrit, mund të konkludohet se Kosova po përballet me mangësi të shumta dhe veçanërisht me vonesa në plotësimin dhe azhurnimin e kësaj kornize. Ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja, si dokument kyç, është shumë i vjetërsuar dhe nuk korrespondon me gjendjen aktuale të cilësisë së ajrit në të cilën ndodhet Kosova, ndërkohë që versioni i rishikuar i tij ende nuk është finalizuar për shkak të kërkesës për të përgatitur vlerësimin e ndikimit financiar si dhe nuk ka shkuar për miratim. Mungesa e një plani të veprimit ka ndikuar që strategjia për cilësi të ajrit të ketë vështirësi gjatë implementimit. Planet emergjente për adresimin e ndotjes alarmante të ajrit, sidomos gjatë periudhës së dimrit, pavarësisht që janë përpiluar, nuk posedojnë raporte të zbatimit të masave të tyre për të arritur në një konkluzion se sa efektive kanë qenë në arritjen e qëllimeve të tyre. Ekzistenca e parakushteve ligjore të mangëta, jo të kompletuara dhe jo të azhurnuara në tërësi sipas gjendjes aktuale të cilësisë së ajrit, nuk shërben si udhërrëfyes i cili do të lehtësonte punën e institucioneve për të ndërmarrë masa konkrete në drejtim të përmirësimit të cilësisë së ajrit.

Sistem jo efikas i monitorimit dhe raportimit të cilësisë së ajrit

Monitorimi dhe raportimi i cilësisë së ajrit karakterizohet po ashtu me mangësi të shumta. Stacionet e monitorimit të cilësisë së ajrit janë të vendosura në pjesën dërrmuese të vendit, dhe aktualisht rrjeti monitorues i cilësisë së ajrit që menaxhohet nga IHMK numëron 12 stacione. Stacionet janë të vendosura përgjithësisht në lokacione ku influencohen nga burime të ndryshme të ndotjes së ajrit. Gjatë përcaktimit të lokacioneve IHMK ka hasur në disa probleme pasi që fillimisht, në disa raste, i është dashur të dislokojë ato për shkak të kërkesave nga komuna, shkolla, faktit që në disa raste është vendosur në pronë private, etj. Njëri nga stacionet është ende i pa dislokuar dhe si rezultat i kësaj është jashtë funksionit.

Një prej mangësive kryesore të stacioneve monitoruese është fakti që një pjesë e konsiderueshme e tyre, për një periudhë jo të shkurtër kohore, si gjatë vitit 2016 ashtu edhe gjatë vitit 2017, kanë qenë jo funksionale, dhe si të tilla nuk kanë raportuar të dhëna për cilësinë e ajrit për muaj të tërë. Arsyeja kryesore e mos funksionimit të stacioneve ka të bëjë me mungesën e mirëmbajtjes dhe servisimit të vazhdueshëm të tyre. Një pjesë e konsiderueshme e stacioneve monitoruese nuk kanë sigurinë e

nevojshme, dhe si rezultat i mungesës së mbikëqyrjes së vazhdueshme kanë qenë pjesë e dëmeve që janë shkaktuar në të shumtën e rasteve nga faktori njeri.

Teknikat e matjes së cilësisë së ajrit janë të standardizuara pasi që të gjitha stacionet janë të pajisura me numër dhe lloj të njëjtë të parametrave kryesor që bëjnë përcaktimin e ndotjes së ajrit me NO₂, CO, SO₂, O₃, PM₁₀ dhe PM_{2.5}. Pavarësisht kësaj, mbledhja e të dhënave nëpër stacione bëhet manualisht, me përjashtim të tre stacioneve të vendosura në Obiliq për të cilat të dhënat merren nga softveri lokal që i merr të dhënat nga to. Në mungesë të një sistemi qendror i cili do bënte mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave në mënyrë automatike, si dhe gjenerimin e raporteve, të dhënat aktualisht përpunohen një nga një nga zyrtarët e IHMK-së. Kjo mënyrë e përpunimit të të dhënave merr shumë kohë të gjatë dhe si e tillë shkakton vonesa të mëdha në raportim të të dhënave të cilësisë së ajrit.

Mangësi shumë e madhe është po ashtu raportimi jo i rregullt dhe jo i plotë i të dhënave për cilësi të ajrit. Si gjatë vitit 2016, ashtu edhe gjatë vitit 2017, ka stacione të shumta që nuk kanë gjeneruar të dhëna për parametra të ndryshëm për muaj të tërë. Akoma më problematik është fakti se edhe gjatë vitit 2017 vazhdon të ketë stacione të monitorimit të cilat janë të vendosura në zona që karakterizohen me ndotje të lartë të ajrit dhe të cilat kanë pasur mungesë të të dhënave për disa prej parametrave për më shumë se 6 muaj gjatë vitit. Më tutje, parametrat më problematik të ndotjes së ajrit në vendin tonë, PM₁₀ dhe PM_{2.5}, nuk janë raportuar për muaj të tërë. Gjatë vitit 2016 këto dy parametra nuk janë raportuar mesatarisht 6.6 muaj, ndërkohë që gjatë vitit 2017 të njëjtat parametra nuk janë raportuar mesatarisht 4.2 muaj gjatë vitit, që nuk janë pak veçanërisht nëse janë muaj të dimrit, kur këta parametra arrijnë vlera maksimale.

Raportimet janë kryesisht në baza mujore, si dhe mungon raportimi në kohë reale i të dhënave për cilësinë e ajrit. Pas një kohë shumë të gjatë, respektivisht duke filluar nga gjysma e tetorit të vitit 2017 IHMK e bënë raportimin në baza ditore vetëm për dy stacionet e vendosura në Prishtinë, ndërsa që për tri stacionet e vendosura në Obiliq ka filluar me raportime ditore prej datës 12 Janar 2018.

Gjendja e cilësisë së ajrit është po ashtu shqetësuese nëse merren për bazë tejkalmimet e regjistruara të vlerave të PM₁₀. Duke qenë se numri maksimal i tejkalimeve të lejuara brenda vitit të vlerave të PM₁₀ është 35 ditë, ky auditim ka gjetur se gjatë viti 2016 ka pasur stacione që kanë pasur tejkalime të këtij parametri rreth 93 ditë, si dhe gjatë vitit 2017 deri në 68 ditë. Ndërkohë që kur janë analizuar vlerat maksimale të PM₁₀ të mesatares ditore, ka pasur ditë kur vlerat e PM₁₀ kanë arritur në rreth 291 (viti 2016) dhe 326 (viti 2017), krahasuar me vlerën maksimale të lejuar që është 50. Në anën tjetër, edhe vlerat maksimale të PM_{2.5} përgjatë një ore kanë arritur nivele jashtëzakonisht të larta dhe një gjë e tillë është akoma më alarmante sa i përket shëndetit të njeriut. Përderisa vlera kufitare e lejuar e PM_{2.5} është 40 µg/m³, gjatë vitit 2016 vlera më e lartë e regjistruar ka qenë 345.9, ndërkohë që gjatë vitit 2017 PM_{2.5} ka arritur vlerën 412.

Si grimcat PM₁₀ ashtu edhe ato PM_{2.5} janë shumë të rrezikshme për shëndetin e njeriut pasi që janë grimca me diametër shumë të vogël dhe si të tilla mund të udhëtojnë më thellë në mushkëritë tona dhe të shkaktojnë efekte të dëmshme për shëndetin tonë. Efektet e mundshme që mund të shkaktohen nga këto grimca janë rritja e numrit të të sëmurëve me astmë bronkiale, bronkitet

kronike, sëmundjet kronike të mushkërive tek moshat e shtyra, rritja e numrit të sëmundjeve kardiovaskulare dhe respiratore, kanceri, shkurtimi i jetës si dhe rritja e shkallës së mortalitetit.

Me këtë sistem të monitorimit dhe raportimit qytetarëve nuk u jepet një pasqyrë reale e gjendjes së cilësisë së ajrit në vend, e sidomos jo në kohë reale si dhe një sistem i tillë përbën rrezikun që të jetë jo funksional e pa të dhëna sidomos në ato raste kur ndotja e ajrit në vend është shumë e rëndë dhe qytetarët të mos jenë në dijeni në kohën e duhur për të marrë masat e nevojshme për të evituar ekspozimin ndaj një ndotje të tillë të ajrit. Po ashtu, parregullsitë e tilla në sistemin e monitorimit dhe raportimit të të dhënave e bëjnë shumë të vështirë për vendimmarrësit identifikimin e masave konkrete për tu ndërmarrë për të përmirësuar gjendjen e cilësisë së ajrit.

Menaxhim jo i duhur i cilësisë së ajrit në nivel lokal

Menaxhimi i cilësisë së ajrit nga niveli lokal është jo i duhur për shumë arsye. Përgjegjësitë për të bërë hartimin e PLVM-ve janë marrë parasysh tek pjesa dërrmuese e komunave që ishin pjesë e auditimit, mirëpo e njëjta gjë nuk mund të thuhet edhe për përpilimin e raporteve të zbatimit të masave të parapara në PLVM. Mungesa e raporteve të zbatimit të masave i pamundëson çdo pale të interesit që të dijë saktësisht se çfarë masash janë ndërmarrë, nëse masat janë ndërmarrë ashtu siç janë planifikuar, nivelin e realizimit të masave, efektin që ato kanë arritur, etj. Boshllëk tjetër është vënë re edhe në komunikimin dhe bashkëpunimin në mes të nivelit lokal dhe qendror. Në këtë aspekt, neglizhenca ka qenë e pranishme tek të dyja anët. Përpjekjet e MMPH për të marrë informacione nga komunat kanë qenë të pa mjaftueshme dhe kërkesa për raportim ka pasur rrallë herë, mirëpo edhe komunat nuk kanë marrë mundin të raportojnë në baza vullnetare apo ashtu siç e kanë për obligim, mirëpo është raportuar në baza ad-hoc dhe vetëm atëherë kur është kërkuar nga ministria apo ndonjë palë tjetër e interesit.

Mangësi tjetër është edhe përfundimi i vlefshmërisë së afateve kohore të PLVM-ve në të gjitha komunat. Lidhur me këtë, shumë pak përpjekje janë bërë nga komunat për të përtërirë PLVM-të për pesë vite të tjera.

Bashkëpunimi i dobët në mes të nivelit qendror dhe atij lokal vihet re edhe në aspekt të monitorimit të cilësisë së ajrit i cili është i centralizuar. Niveli lokal përveç që nuk ka qasje në këtë proces, nuk është i përfshirë në asnjë mënyrë, si dhe shpesh herë pret kohë të gjatë për të iu raportuar të dhënat që gjenerohen nga stacioni/et që gjenden në territor të komunës. E kyçur në mënyrë direkte në monitorim të gjendjes së cilësisë së ajrit është vetëm komuna e Prishtinës e cila përveç që pranon të dhëna nga stacionet e IHMK-së, me vetiniciativë ka instaluar 6 pajisje monitoruese të cilat masin cilësinë e ajrit në 6 lagjet kryesore të komunës. Fatkeqësisht këto pajisje bëjnë matjen vetëm të parametrin problematik në vendin tonë PM_{2.5}, e jo edhe të PM₁₀. Komuna e Prishtinës dhe IHMK nuk kanë koordinim lidhur me të dhënat për cilësinë e ajrit që raportohen nga pikat monitoruese të vendosura nga vet komuna si dhe dy stacionet monitoruese që menaxhohen nga IHMK. Mungesa e koordinimit ka rezultuar shpesh herë në paraqitje të ndryshme të të dhënave, dhe kjo gjë ka shkaktuar konfuzitet në mesin e qytetarëve. Vërejtjet e bëra shpesh herë nga komunat tek ndotësit e mëdhenj të ajrit siç janë termocentralet e prodhimit të energjisë tek ne apo fabrikat e çimentos janë shpërfillur dhe si rezultat i kësaj shpërfilljeje gjendja ka vazhduar të jetë e njëjtë.

5 Rekomandimet

Rekomandimet e dhëna më poshtë kanë për qëllim të sigurojnë se entitetet përgjegjëse, respektivisht MMPH, AMMK, IHMK dhe komunat implementojnë praktika efikase të menaxhimit të gjendjes së cilësisë së ajrit në vend.

Rekomandojmë MMPH, AMMK dhe IHMK, të:

- Përfundojë sa më parë vlerësimin e ndikimit financiar të Ligjit për mbrojtjen e ajrit nga ndotja dhe të bëjë miratimin e versionit të ri të këtij ligji;
- Komplettojë legjislacionin sekondar, duke i dhënë përparësi miratimit të versionit të rishikuar të UA për rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes;
- Funkcionalizojë brenda një kohë të shkurtër Strategjinë për cilësi të ajrit përmes miratimit të PVCA 2018-2020;
- Përpilojë raporte të zbatimit të masave të parapara në planet emergjente 2016/2017 dhe 2017/2018;
- Monitorojë dhe inspektojë në mënyrë të vazhdueshme veprimtarinë e operatorëve ekonomik të cilët konsiderohen si ndotës të mëdhenj të ajrit. Të mos bazohet vetëm në raportet që gjenerohen nga ta, mirëpo të realizojë vizita të shpeshta inspektuese për të verifikuar raportimet e tyre lidhur me ndotjen e ajrit që shkaktohet nga veprimtaria e tyre;
- Funkcionalizohet në tërësi rrjeti monitorues i cilësisë së ajrit përmes servisimit të të gjitha stacioneve, dislokimit të atyre stacioneve që ende nuk janë dislokuar në lokacione adekuate, mirëmbajtjes së vazhdueshme të tyre përgjatë tërë vitit si dhe përmirësimit të sigurisë së stacioneve për të evituar dëmet e mundshme;
- Krijojë një sistem të centralizuar të mbledhjes dhe përpunimit automatik të të dhënave që gjenerohen nga stacionet monitoruese, si dhe një sistem që është në gjendje të gjenerojë në mënyrë automatike raporte përmbledhëse për secilin prej stacioneve monitoruese;
- Sigurojë matje dhe raportim në kohë reale të cilësisë së ajrit për secilin prej stacioneve monitoruese si dhe për të gjithë parametrat që përmbajnë këto stacione;
- Monitorojë në mënyrë të vazhdueshme në veçanti tejkallimet e vlerave kufitare të parametrave që e ndotin ajrit (sidomos grimcave PM₁₀ dhe PM_{2.5}), dhe të merren masa adekuate dhe të menjëhershme për përmirësimin e gjendjes.
- Intensifikojnë bashkëpunimin me nivelin lokal në aspekt të monitorimit, raportimit dhe informimit të tyre për gjendjen e cilësisë së ajrit që gjenerohet nga rrjeti i centralizuar i monitorimit të cilësisë së ajrit.

Rekomandojmë komunat, të:

- Miratojnë PLVM-të sa më parë që është e mundur (në këtë rast komuna e Prishtinës), si dhe për pjesën tjetër të komunave të cilave u ka kaluar vlefshmëria kohore e PLVM-ve, ti ripërtërijnë ato sa më parë për një periudhë tjetër pesë vjeçare.
- Përpilojnë raportet e zbatimit të masave të parapara në PLVM, sidomos ato masa që kanë për qëllimin adresimin e ndotjes së ajrit. Raportet të përfshijnë numrin dhe llojin e masave të realizuara, shkallën e realizimit të tyre, kostot e përfshira për realizimin e tyre, si dhe efektin që pritet të arrijnë ato në përmirësim të cilësisë së ajrit.
- Raportojnë në baza tre mujore, jo vetëm për zbatimin e masave të parapara në PLVM, mirëpo për çdo aktivitet të kryer nga komuna që në mënyrë direkte apo indirekte ndikon në përmirësimin e cilësisë së ajrit. Po ashtu, të sinjalizohet niveli qendror në mënyrë të vazhdueshme për problemet që mund ti shkaktohen komunës me ndotjen e ajrit nga veprimtaria e ndotësve të mëdhenj të ajrit.

Shtojca 1

Parametrat monitorues ndotës dhe efektet në shëndet dhe mjedis

SO₂ (Dioksidi i sulfurit)- është gaz toksik me veti acidike, pangjyrë dhe erë të forte. Burimet kryesore prej nga prodhohet ky gaz janë kapacitetet energjetike dhe ngrohtoret, transporti, të cilat shfrytëzojnë naftën dhe thëngjillin me cilësi të dobët e të cilat përmbajnë sulfur.

Ndikimet në shëndet dhe mjedis. Janë të njohura efektet në zvogëlimin e volumit mushkëror, rritja e rezistencës së frymëmarrjes dhe simptome të tilla si pengesa në frymëmarrje, ngushtime në gjoks dhe zvogëlim të ritmit të frymëmarrjes. Mund të shkaktojë kokë dhimbje dhe iritime të hundës. Dioksidi i sulfurit është ndër shkaktari kryesor i të ashtuquajturave shirat acidike, të cilat përshpejtojnë korrozionin e objekteve të ndërtimit dhe acidifikimin e dheut, liqeneve dhe rrjedhave të lumenjve.

NO₂ (Dioksidi i azotit)- NO₂ përfaqëson rreth 80% të NO_x). NO₂ është gaz toksik, i cili kryesisht vjen nga djegia në makina, ngrohtore dhe nga termocentralet.

Ndikimet në shëndet dhe mjedis. Oksidet e azotit kanë efekte të theksuara në mushkri por edhe në organet tjera si në mëlçi dhe shpretkë. Në gjak ka aftësi për krijim të meta hemoglobinës, e cila nuk lejon transportimin e oksigjenit. Gazrat nitroze në ajër mund të shndërrohen në shira acidike. Gjithashtu NO dhe NO₂ janë kontribuues në hollimin e shtresës së ozonit.

CO (Monoksidi i karbonit)- është gaz shumë helmues dhe i djegshëm. Kryesisht është produkt i djegies jo komplete të lëndët djegëse. Konsumimi i duhanit në objekte të banimit, në zyre, makina dhe restorante e rrit përqendrimin e monoksidit të karbonit.

Ndikimet në shëndet dhe mjedis. Qëndrimi i zgjatur në mjedis ku është prezent CO mund të zvogëlojë sasinë e oksigjenit për frymëmarrje deri në at masë sa njeriu humb vetëdijen si shkak i mungesës së oksigjenit(asfiksi). Monoksidi i karbonit kontribuon në efektin në Gazrat Serrë dhe ngrohjen globale.

O₃ (Ozoni)- është substancë me toksicitet të lartë dhe me veti korrozive të theksuara që njihet si ndotës i zakonshëm. Ozoni formohet në atmosfere nga reaksioni mes oksideve të azotit, hidrokarbureve dhe dritës së diellit. Shumë nga pajisjet elektrike, si për shembull, televizorët, fotokopjuesit dhe motorët elektrik (që shfrytëzojnë brushat), prodhojnë sasi të tilla të ozonit sa njeriu shumë lehtë mund t'i nuhas si aromë.

Ndikimet në shëndet dhe mjedis - ndikimet akute përfshijnë simptomat në sistemin respirator, ndryshime në funksionimin e sistemit mushkëror, rritje e ndjeshmërisë respiratorë dhe inflamacione respiratorë. Ozoni dëmton bimësinë dhe pyjet (efekti i foto oksidimit), prishjen e pamjes së qyteteve, parqeve nacionale dhe hapësirat për rekreacion.

PM₁₀/PM_{2.5} (Grimcat e pluhurit) - këto dy lloje të grimcave nuk janë kompozime të veçanta, por përqendrimi i masës së suspenduar në ajër që kanë diametër më të vogël se 10 µm (PM₁₀) ose diametër më të vogël se 2.5 µm (PM_{2.5}). Posaçërisht në lokalitetet me trafik të dendur kur këta

parametra tejkalojnë pragjet e lejuara apo VML, për publikun dhe popullsinë janë me rëndësi të veçantë.

Ndikimet në shëndet dhe mjedis. Një numër i madh i studimeve tregojnë ndikime afatshkurtër në sistemin kardiovaskular, të cilat ndërlidhen me PM, ndërsa ndikime direktë në një numër të sulmeve në zemër janë argumentuar se shkaktohen nga prezenca e PM në ajër. Efekte afatgjata konsiderohen grimcat e pluhurit PM, të cilat kanë përmbajtje toksikologjike e të cilat sulmojnë sistemin respirator dhe zvogëlim të imunitetit për shkak të depërtimit të PM në thellësi të mushkërive dhe në pjesët bronkiale veçanërisht PM_{2.5}.

Normat e cilësisë së ajrit sipas Udhëzimit Administrativ Nr.02/2011

Parametri	Vlerat limite	Njësia matëse	Vlera limite(kufitare) $\mu\text{g}/\text{m}^3$	Tejkalimet e lejuara për ditë brenda vitit
NO ₂	Vlera limite për 1 orë, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	200	18
	Vlera limite vjetore, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	40	Nuk parashihet
	Vlera limite vjetore, për mbrojtjen e vegjetacionit	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	30	Nuk parashihet
SO ₂	Vlera limite për 1 orë, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	350	24
	Vlera limite për 24 orë, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	125	3
CO	Vlera limite për mesataren ditore të maksimale 8-orëshe, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	mg/m^3	10	Nuk parashihet
PM ₁₀	Vlera limite për 24 orë, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	50	35
	Vlera limite vjetore, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	40	Nuk parashihet
PM _{2.5}	Viti kalendarik	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	25	Nuk parashihet
O ₃	Objektivi afatgjatë, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	120	Nuk parashihet
	Pragu i informimit	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	180	Nuk parashihet
	Pragu i alarmit	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	240	Nuk parashihet